



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.05.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datës 07.05.2018, 08.05.2018, 09.05.2018 dhe 14.05.2018.
2. Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin nr. 34, datë 20.5.2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.” *(Komisioni përgjegjës)*
3. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017. *(Komisioni përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Elena Xhina, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Tom Doshi, Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bledar Çuçi, Nasip Naço, Silva Caka.

Të ftuar:

Erinda Ballanca – Avokate e Popullit

Enio Haxhimihali – Drejtor Kabineti

Fatbardh Zenelaj – Sekretar i Përgjithshëm

Kledia Ngjela – Këshilltare

Ermonela Xhafa – Komisionere e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues

Arben Shkëmbi – Komisioner i Seksionit të Veçantë

Alket Jaupi –Ndihmëskomisioner

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kuorumi është prezent për të vazhduar me rendin e ditës.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, për datat 7.05.2018, 08.05.2018, 09.05.2018 dhe 14.05.2018.

Ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratohen procesverbalet e mbledhjeve të datës 7.05.2018, 08.05.2018, 09.05.2018 dhe 14.05.2018.

Pika e dytë e rendit të ditës është projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 34, datë 20.5.2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.” Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Bashkim Fino.

Zoti Fino, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të lutem!

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Ka ardhur struktura e re e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Është një strukturë, që, realisht, me firmën tuaj ose të sekretarit të Përgjithshëm duhet t’i kërkohet mendim Ministrisë së Financave dhe DAP-it, sepse pa dhënë ata mendimet konkrete për ndryshim strukture, ne nuk mund ta kalojmë në komision.

Kemi bërë një konsultë me Komisionerin dhe i kemi kërkuar të merren këto dy mendime, nga Ministria e Financave dhe DAP-i...

Ulsi Manja – Ju lutem, qetësi!

Bashkim Fino – Mbasi të merren këto dy mendime, atëherë besoj se do të jemi gati brenda një jave për ta trajtuar në komision. Është çështje procedure. Prandaj nuk po e kalojmë sot këtë çështje, për shkak se ishte e pakompletuar dosja që do t’u vihej në dispozicion të gjithë deputetëve të komisionit.

Ulsi Manja – Pra, ta heqim nga rendi i ditës dhe ta shtyjmë për mbledhjen tjetër?

Bashkim Fino – Po, ta shtyjmë, sepse presim përgjigje nga dy institucione, nga Ministria e Financave, sepse për çdo strukturë shprehet ajo, si dhe nga Departamenti i Administratës Publike.

Ulsi Manja – Jeni dakord me propozimin e kolegut Fino, lidhur me këtë projektvendim?
Dakord.

Atëherë, e shtyjme pikën e dytë të rendit të ditës për mbledhjen e radhës ose kur të na vijne përgjigjet nga Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike.

Si pikë të tretë të rendit të dritës kemi raportin vjetor të Avokatit të Popullit për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017. Edhe për këtë rast komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore është kolegja Elena Xhina.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga institucioni i Avokatit të Popullit: zonja Erinda Ballanca, Avokate e Popullit; zoti Enio Haxhimihali, drejtor i Kabinetit; zoti Fatbardh Zenelaj, sekretar i Përgjithshëm; zonja Kledia Ngjela, këshilltare; zonja Ermonela Xhafa, komisionere e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, zoti Arben Shkëmbi, komisioner i Seksionit të Veçantë dhe zoti Alket Jaupi, ndihmëskomisioner.

Zonja Avokate e Popullit, mirë se keni ardhur në komision, së bashku me stafin tuaj!

Është një raportim i punës së Avokatit të Popullit për vitin 2017. Raporti analitik, i detajuar, që ju keni sjellë pranë Komisionit të Ligjeve u është shpërndarë kolegëve deputetë. Gjithsesi, do t'ju lutesha të bënit një përmbledhje shumë të shkurtër për kolegët, por edhe për opinionin publik, lidhur me veprimtarinë e institucionit që ju drejtoni për vitin 2017.

Fjala është për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka kërkuar fjalën për procedurë kolegu Alibeaj, sepse ka deklaratën e radhës. Po më vjen keq, se po ia merr fjalën Avokates së Popullit dhe sot duhet të flasë populli këtu dhe jo deputetët!

Enkelejd Alibeaj – Pikërisht për këtë arsye, ne që jemi përfaqësues të popullit duhet të flasim të parët, sepse kam përshtypjen se barra më e madhe për të folur në mënyrë të sinqertë për popullin, i bie atyre që janë të zgjedhur nga populli, jo vetëm se janë të zgjedhur nga populli, por kanë vendosur edhe dorën mbi Kushtetutë, se do ta respektojnë Kushtetutën dhe do të mbrojnë interesat e popullit.

Unë e kuptoj që ju jeni në një siklet të madh dhe keni një stomak të fortë për të vazhduar një veprimtari, mbi të gjitha, të këtij komisioni, për çështjen më të madhe, që i intereson popullit, publikut...

Ulsi Manja – Më kishte munguar nënkryetari, prandaj ia dhashë fjalën.

Enkelejd Alibeaj – Do të ta nxjerr mallin dhe jo vetëm.

Ulsi Manja – Kisha shumë dëshirë.

Enkelejd Alibeaj – Nuk ka moment më të mirë (sidomos në këtë sallë, në prani edhe të Avokates së Popullit) se sot për të diskutuar për çështjen që ka interesin dhe sensibilitetin më të madh publik, zoti Kryetar, atë që populli ka të paktën 15 ditë që po e ndjek, po e përgjon dhe është i interesuar të dijë të vërtetën, e për më tepër, për të kuptuar sjelljen e atyre, të cilët janë duke kërkuar me vetëmohim për të fshehur të vërtetën.

Ndaj populli, skandalin më të madh të këtij vendi në pothuajse 27 apo 28 vjet... Sot, kur të gjithë e kanë të qartë si drita e diellit se ç'ka ndodhur, thirrja e vetme që ne mund t'i bëjmë njëri-tjetrit për përgjegjësinë publike që kemi, si të zgjedhur nga populli, është një reflektim i ndërgjegjes sonë individuale politike.

Së paku, ju anëtarë të maxhorancës së Komisionit të Ligjeve sot nuk e bëtë si kolegët tuaj në Komisionin e Medies dhe atë të Veprimtarisë Prodhuese, që e bojkotuan pa gjetur guximin për t'u përballur me këtë realitet. Për këtë arsye...

Ulsi Manja – Si mund të bojkotojmë Avokatin e Popullit ne?! Është institucion i rëndësishëm.

Enkelejd Alibeaj – Kjo është një lloj merite e vogël juaja...

Ulsi Manja – S'mund ta bojkotojmë.

Enkelejd Alibeaj – Të lutem, mos më ndërprit! Nuk është kjo mënyra më e mirë... Unë sa ju lavdërova për faktin se gjetët guximin...

Ulsi Manja – Ti rrofsh, faleminderit, por...!

Enkelejd Alibeaj –...ndoshta të detyruar për t'u përballur me këtë problem.

Besoj se ajo që duhet të bëni pas këtij hapi të vogël, është t'i bëni një thirrje të vogël ndërgjegjes suaj të fshehur brenda, mbi përgjegjësinë politike që ka gjithsecili prej jush, së paku ata, të cilët deri në këto momente e më parë nuk janë përfshirë në veprimtari dhe vorbulla kriminale, siç është përfshirë Kryeministri apo ministri i Brendshëm me familjarët tij, përfshirje që po tregohet ditë për ditë.

Së paku, ju duhet të shpëtoni lëkurën tuaj politike, nëse nuk keni gisht në këtë histori. Jo vetëm kaq, por, nga ana tjetër, nëse nuk i bëni dot thirrje ndërgjegjes suaj, përgjegjësisë suaj individuale, politike. Bëjini thirrje përgjegjësisë suaj politike, jeni përfaqësues edhe të socialistëve të ndershëm, të atyre, që kur kanë menduar dhe ju kanë dhënë votën, asnjëherë nuk u ka shkuar nëpër mend që përfaqësuesit e tyre do të ishin “kapo” të familjeve kriminale, do të ishin drejtues

të trafikut të narkotikëve, do të ishin udhëheqës dhe dirigjues të fenomenit kriminal ku e ka zhytur kjo qeveri...

Ulsi Manja – Mos ua qaj hallin socialistëve..

Enkelejd Alibeaj – Nëse edhe këtë nuk e bëni...

Ulsi Manja – I përfaqëson ky krahu këtej socialistët...

Enkelejd Alibeaj - ... siç po e shoh, të paktën jemi në Komisionin e Ligjeve dhe ky është vendi ku do të duhet të diskutohet për përgjegjësinë ligjore, për të cilën keni bërë çfarë ka qenë e mundur dhe sot po ia shohin shqiptarët frytet e hidhura të veprimtarisë së komisioni, pse jo, me kapjen e prokurorisë, me kapjen e Prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm, me kapjen e drejtuesit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Ja pra, pse kanë ndodhur të gjitha këto ngjarje kohë më parë, sepse e dinit që do të vinit në këtë ditë të zezë për ju, por të zezë edhe për shqiptarët që kurrë nuk e menduan se do të vinte një ditë kaq shpejt që drejtësia kaq shumë e veneruar të shërbente si një mjet për të mbrojtur Agronin, Geronin, Fatmirin, Edin dhe vëllezërit respektivë të tyre.

Pra, nuk mund të bëhet sot një drejtësi...

Ulsi Manja – A mund t'ia jap fjalën Avokates së Popullit?

Enkelejd Alibeaj – Ja, sa të mbaroj.

... edhe për popullin që mbron Avokati i Popullit, ku shqiptarët kanë kërkuar kaq shumë drejtësi, ku ministri i Brendshëm drejtpërdrejtë i përfshirë dhe i akuzuar në veprimtari kriminale vazhdon të mbajë detyrën e tij në konflikt të pastër me ligjin, sepse është njeriu, i cili caktoi Prokurorin e Përgjithshëm, shkroi ligjet në këtë mënyrë, emëroi drejtuesit e prokurorisë, lidhi memorandum me Prokurorin e Përgjithshëm për të krijuar një prokurori që do të duhej të luftonte krimin. Cilin krim? Të Agron Xhafajt, Geron Xhafajt, edhe tëndin për mbështetjen që i ke dhënë atij dhe ky është momenti ku duhet mbajtur qëndrim i qartë ligjor, për të cilin edhe Avokati i Popullit do të duhet të mbajë edhe përgjegjësinë e tij për 2018-ën...

Ulsi Manja – Ju lutem, përmbylleni fjalën, sepse nuk po tregojmë fare respekt për avokatin...

Enkelejd Alibeaj – Ne duhet të tregojmë respekt për popullin, për publikun, kjo është ajo që na mbledh ne këtu...

Ulsi Manja – Ju përfaqësoni popullin opozitar, jo popullin...

Enkelejd Alibeaj – Ne përfaqësojmë demokratë...

Ulsi Manja – Për popullin është Avokati Popullit, të cilin e keni përballë...

Enkelejd Alibeaj - ... socialistë, njerëz që e duan këtë vend që të mos të jetë pre e një qeverie, e cila e ka emrin bandë kriminale, këtë e marrim përsipër dhe do të duhet ta marrim përsipër, ftesa është që ta merrni edhe ju...

Ulsi Manja – Unë ju ftoj ta merrni përsipër...

Enkelejd Alibeaj - ... dhe ky është momenti, i cili do të ngelet si një njollë në historinë politike të gjithsecilit prej jush, i cili nuk del dot nga ky rreth kriminal. Keni nderin tuaj për të mbrojtur, kush nuk është i përfshirë në krim nuk ka pse t'i bëhet mbrojtje Fatmir Xhafajt, Edi Ramës dhe Agron Xhafajt. Historia është ajo që do t'ju gjykojë të gjithëve...

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Ballanca...

Enkelejd Alibeaj - ... e mbi të gjitha...

Jo, nuk flet dot zonja Ballanca në emër të popullit deri sa të mbaroj unë...

Ulsi Manja – Po mirë të ikë në shtëpi zonja ose tek institucioni...

Enkelejd Alibeaj – Jo, ti mund ta mbyllësh dhe mund të ikësh, por kjo nuk është mënyra...

Ulsi Manja – Jo, nuk është kjo mënyra. Ju lutem...

Enkelejd Alibeaj - ... sepse keni një detyrim, sigurisht për...

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Ballanca, si Avokate e Popullit nuk vjen këtu të dëgjojë deklaratat politike, por ka ardhur të kryejë detyrën...

Enkelejd Alibeaj – Ky është vendi ku diskutohet...

Ulsi Manja - ... nëse ju vazhdoni të bëni deklaratat politike, atëherë ta përcjellim Avokaten e Popullit dhe vazhdojmë si të doni ju me deklaratat politike.

Enkelejd Alibeaj – Ulsi, në këtë pozicion që je...

Ulsi Manja – A mund ta përmbledhësh fjalën, të lutem, ose ta përcjellim zonjën dhe vazhdojmë debatin!

Enkelejd Alibeaj – Po pse ta përcjellim zonjën? Zonja dhe zotërinjtë t'i dëgjojnë këtë histori, sepse ke detyrimin...

Ulsi Manja – Ju kanë dëgjuar nga mëngjesi në darkë dhe po ju dëgjojnë përditë.

Enkelejd Alibeaj - .. së bashku me ne ke detyrimin të bësh transparencë politike...

Ulsi Manja – A mund ta përmbledhësh fjalën, të lutem!

Enkelejd Alibeaj – Jemi këtu për publikun shqiptar, i cili duhet të dijë se çfarë është duke gatuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Ta mbaroj fjalën.

(Diskutime pa mikrofon)

Paskeni një muaj që e...

Ulsi Manja – Unë nuk do të dëgjoj Babalen në komision, mik...

Enkelejd Alibeaj – Ti do të dëgjosh bëmat e Babales, se në qoftë se nuk do të dëgjosh Babalen, nuk duhet të dëgjosh as Agron Xhafajn...

Ulsi Manja – Ju lutem, përmbylleni fjalën!

Enkelejd Alibeaj - ... nuk duhet të dëgjosh as Fatmir Xhafajn, madje më tepër se kaq do të duhet të ndëshkosh moralisht, politikisht dhe ligjërisht, meqë jemi në një komision ligjor edhe Fatmir Xhafajn, edhe Edi Ramën, është detyrimi yt, sepse e mban këtë karrige pikërisht për këtë arsye...

Ulsi Manja – Ju ftoj ta përmbyllni fjalën dhe të vazhdojmë me pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet!

Enkelejd Alibeaj – Në qoftë se ju keni vendosur të mbyllni sytë, të mbyllni veshët, të tregoni siç po e tregon edhe Kryeministri faktin që ka filluar një pelegrinazh në Gjirokastrë, në Tepelenë për t'i treguar të gjitha, një realitet, një fasadë që nuk ekziston, besoj se ky është teatri më hipokrit dhe më i shpifur që ju po u bëni shqiptarëve. Shqiptarët sot duan të dinë pikërisht këtë gjë: pse Fatmir Xhafaj, e mbron një kriminel, vëllain e tij? Pse Edi Rama, e mbron një kriminel, vëllanë e ministrit të Brendshëm dhe ministrin e Brendshëm? Pse Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj vënë nën presion prokurorinë dhe kanë kapur prokurorinë? Pse e keni zhytur këtë vend në këtë vorbull? Kjo është ajo çka duan të dëgjojnë qytetarët, publiku, populli, Avokati i Popullit dhe çdo deputet, i cili beson se mbron këtu interesat e popullit shqiptar. Po mesa duket ju nuk jeni më ata mbrojtësit e devotshëm të vegjëlisë, as të socialistëve dhe ky është momenti kur shqiptarët kudo, të majtë dhe të djathtë, socialistë dhe demokratë, njerëz, të cilët nuk e duan vendin e tyre pre të kimit, të drogës, të bandave, qofshin ato në qeveri, ta marrin fatin e tyre në dorë. Nuk i dilni ju përgjegjësisë qeverisëse, e marrin shqiptarët dhe kjo është arsyeja, sepse në 26 maj, ditën e shtunë, do ta marrin ata në dorë dhe ky është momenti juaj i fundit së paku për të kërkuar ndjesë. E di që nuk do ta bëni, por 26 maji është momenti dhe dita kur shqiptarët do të flasin fort, saktë, një herë e përgjithmonë!

Edhe Avokati i Popullit duhet ta bëjë këtë gjë, t'i japi zë popullit, t'i japi zë diskriminimit që po ndodh, t'i japi zë humbjes së lirisë dhe asfiksionit të ardhmes së këtij vendi. Është mbi të gjitha detyrë morale e çdo shqiptari, fatet i bëjmë vetë, të ardhmen e kemi në dorë, të shporret një orë e më parë kjo bandë qeverisëse dhe do të marrë frymë e gjithë Shqipëria.

Nuk e di si do të keni tani një stomak të fortë për të vazhduar me miratimin e strukturës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ulsi Manja – Do të vazhdojmë me raportin vjetor të Avokatit të Popullit.

Enkelejd Aliebeaj – Si do të thoni? Sigurisht, është e pamundur.

Si ka mundësi të jeni kaq të pandjeshëm ndaj njerëzve, ndaj atyre për të cilët përgjëroheni, ashtu siç po bën sot ai, që ka dalë me tuta sportive.

Është mirë që secili të marrë përgjegjësitë e veta (morale mbi të gjitha).

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Aliebeaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Zonja Avokate e Popullit, fjala është për ju, për të bërë një përmbledhje të shkurtër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Nuk ka nevojë. Foli njëri për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Folët dje 2 orë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Avokate e Popullit, fjala për ju!

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të kisha dëshirë që raportimi juaj në këtë komision të ishte bërë në datën 26 maj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Avokate e Popullit, fjala për ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

... por është e pamundur, sepse në fakt në datën 26 maj në historinë e parlamentarizmit dhe të pluralizmit politik në Shqipëri ka ndodhur dhunimi më madh që mund t'i bëhej një opozite.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo opozitë ka qenë Partia Socialiste e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjala për ju, zonjë!

Mund të vazhdoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi ta fikni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tregoni pak respekt për Avokaten e Popullit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot kam thirrur Avokaten e Popullit!

Unë nuk dëgjoj fare nga ky vesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po si do të të marr vesh unë ty?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi të vazhdoni, zonja Ballanca?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbledhjen e drejtoj unë. Vazhdoni me raportimin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erinda Ballanca – Unë dua të flas dhe të më dëgjoni, jo të flas dhe të mos të më dëgjoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky nuk është konflikti im zoti Manja.

Ju lutem shumë! Unë dua të flas dhe të dëgjohem. Ndryshe nuk ka kuptim.

Unë dua të më jepni fjalën dhe të më dëgjoni.

Ulsi Manja – Fjala për ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk pranoj unë njeri të më vijë dhe të më bëjë moral në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fole për procedurën dhe për të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot po e mbron baba yt atë. Ai është bërë avokati më i mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam socialist. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erinda Ballanca – Ky nuk është problemi im, zoti Manja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – A ka mundësi?

Mund të vazhdoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erinda Ballanca – Pikërisht, sepse unë nuk dua të bëhem pjesë e politikës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky nuk është debat për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mundem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – A ka mundësi të flas unë, zonja avokate?

Mbledhja mbyllet këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pas pushimit do të vazhdojmë me Avokaten e Popullit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.05.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i raportit vjetor për veprimtarinë e Avokati të Popullit gjatë vitit 2017. (*komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Elena Xhina, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Tom Doshi, Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bledar Çuçi, Nasip Naço, Silva Caka.

Të ftuar:

Erinda Ballanca – Avokat i Popullit
Enio Haxhimihali – Drejtor i Kabinetit të Avokatit të Popullit
Fatbardh Zenelaj – sekretar i Përgjithshëm tek Avokati i Popullit
Kledia Ngjela – Këshilltare pranë institucionit të Avokatit të Popullit
Ermonela Xhafa – Komisionere e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar pranë institucionit të Avokatit të Popullit
Arben Shkëmbi – Komisioner i Seksionit të Veçantë pranë institucionit të Avokatit të Popullit
Alket Jaupi – Ndihmëskomisioner pranë institucionit të Avokatit të Popullit

Ulsi Manja – Ju lutem, kini vëmendjen!

Ftohet media të jetë e pranishme në sallë.

Rifillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve me pikën e tretë të rendit të ditës: raportimin vjetor të institucionit të Avokatit të Popullit për veprimtarinë e tij gjatë vitit 2017.

Siç e thashë në fillim të mbledhjes, raporti analitik i institucionit të Avokatit të Popullit është depozituar në Komisionin e Ligjeve. Natyrisht, nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvend është sjellë edhe një relacion përmbledhës lidhur me veprimtarinë e Avokatit të Popullit, të cilin kolegët e kanë përpara.

Zonja Avokate, do t'ju lutesha të na bënit shkurtimisht një përmbledhje të gjetjeve të këtij raporti për kolegët, si dhe për opinionin publik dhe mediet.

Fjala është për ju.

Erinda Ballanca – Ju falënderoj, zoti Manja!

Gjatë vitit 2017 institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur një sërë arritjesh, ku, në gjykimin tim, arritja kryesore është realizimi me sukses i angazhimeve të Avokatit të Popullit në kuadër të zbatimit të reformës në drejtësi. Mendoj se dhënia e kompetencave këtij institucioni për të kryer të gjithë procesin paraprak të verifikimit të kandidatëve, si dhe të përzgjedhjes së disa prej tyre në organet përkatëse të drejtësisë ka qenë një vlerësim shumë i madh nga ana e parlamentit dhe ne e kemi realizuar këtë gjë me sukses.

(Diskutime në sallë)

Ulsi Manja – Ju lutem, kolegë, pak qetësi!

Erinda Ballanca – Ajo ka qenë një punë shumë voluminoze, e cila i është ngarkuar institucionit tonë pa personel shtesë dhe pa buxhete shtesë, qësigurisht ka marrë edhe kohë nga trajtimi i problematikave të institucionit në mënyrë të përditshme.

Kolonat që institucioni ynë ka janë dy:

Kolona e parë ka të bëjë me trajtimin e ankesave individuale të qytetarëve, ndërsa kolona e dytë ka të bëjë me promovimin e të drejtave të njeriut dhe standardeve më të larta të të drejtave të njeriut.

Nëse për rastin e parë, pra të aplikimit, të marrjes së ankesave drejtpërdrejt nga qytetarët apo nisjes së rasteve me iniciativë, ne kemi pasur një numër të qenësishëm ankesash (rreth 4 mijë e 500 ankesa, të cilat janë trajtuar gjatë këtij viti), për sa i përket çështjes së promovimit të të

drejtave të njeriut jemi përpjekur që, gjithsesi, të jemi një institucion lider në këtë fushë, pavarësisht se me të gjitha kërkesat që kemi pasur gjendja e buxhetit të institucionit nga viti 2017 ka qenë e përgjysmuar në krahasim me vitet e mëparshme, ndërkohë që viti 2018 ka edhe një ulje të mëtejshme jo për shkak se Kuvendi ka miratuar më pak fonde, por sepse projekti “DANIDA”, i cili ka mbështetur ecurinë e institucionit, nga krijimi i tij deri në mesin e vitit 2017, është mbyllur. Prandaj, në këto kushte, do të duhet që institucioni të mbështetet me fonde të tjera për të bërë detyrën, të paktën në nivelin në të cilin ka qenë vitet e mëparshme.

I vetmi vit në të cilin ka pasur një numër më të madh ankesash se sa viti 2017 ka qenë viti 2016, në të cilin ka pasur një numër prej 5512 ankesash të paraqitura, ndërsa në vitin 2017 kemi pasur 4546 ankesa.

Për sa u përket rekomandimeve, kuptohet, jo të gjitha ankesat dalin me një rekomandim për faktin se mund të jenë të pambështetura, mund të jenë jashtë juridiksionit, por rëndësi ka që qytetarët, në mënyrë të vazhdueshme, kanë aplikuar, janë munduar dhe kanë paraqitur kërkesa pranë zyrës së Avokatit të Popullit. Na ka ndihmuar në lidhje me këtë çështje edhe hapja e zyrave tona rajonale, siç edhe ju e dini, por ndërkohë kemi një problematikë me to, pasi një numër i këtyre zyrave (shqetësim të cilin ia kemi bërë prezent edhe Kryetarit të Kuvendit) janë lëvizur nga pushteti qendror, pra nga godina qendrore në qendër të qyteteve kanë lëvizur nëpër godina goxha larg qendrave të qyteteve, dhe aksesit i qytetarëve nuk ka qenë i mundur ose nuk janë lehtësisht të aksesueshme.

Në lidhje me këtë çështje, i kemi drejtuar një ankesë Kryetarit të Kuvendit, në mënyrë që ai të ushtrojë eventualisht kompetencën e tij për të tërhequr vëmendjen që zyrat rajonale të Avokatit të Popullit të pozicionohen përsëri në zona lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët.

Është e qartë se maxhoranca parlamentare e ka shumë të rëndësishme vëmendjen për të dëgjuar problematikat e qytetarëve, çka tregon se edhe vetë platformën e bashkëqeverisjes qeveria e ka gjetur si një mënyrë që zëri i qytetarëve të vijë sa më afër institucioneve, të cilat zgjidhin problemet e tyre dhe për t'u ndier që qeverisja po bëhet në mënyrën më të mirë për qytetarët.

Në këtë kuadër, është vërejtur se edhe ajo platformë po funksionon, kuptohet, me kompetenca të tjera apo me facilitete të tjera.

Unë do të kisha dashur shumë që edhe ne të kishim të njëjtat mundësi dhe facilitete, si institucioni i Avokatit të Popullit, në kuadër të përgjegjshmërisë që organet e administratës shtetërore do të kishin për të na kthyer përgjigje dhe për të ulur, le të themi, numrin e

problematikave që ne kemi në rastet e moskthimit të përgjigjeve apo të moszbatimit të rekomandimeve. Gjithsesi, mendoj se platforma e bashkëqeverisjes rezulton pozitive për sa i përket zgjidhjes së halleve të qytetarëve dhe këtë shpresojmë ta arrijmë edhe ne, duke pasur ndoshta një frymë më të mirë bashkëpunimi nga ana e organeve të pushtetit lokal, por edhe nga ana e organeve të qeverisjes qendrore në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që ne japim.

Unë dua t'ju parashtoj se ne kemi bërë edhe një dëgjese në Komisionin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, ku një numër të madh të problematikave që u përkasnin këtyre fushave i kemi trajtuar atje. Prandaj, me lejen tuaj, do të raportoj këtu ato fusha (në qoftë se ju keni pyetje, sigurisht mund të m'i bëni edhe nga ato fusha), të cilat nuk janë trajtuar në atë komision.

Sipas Komisionit të Shëndetësisë, ata do të dalin edhe me një rekomandim drejtpërdrejt për ju për fushat e tyre në lidhje me gjetjet apo problematikat që u analizuan aty. Megjithatë, në qoftë se ju doni t'i dëgjoni edhe ato problematika, unë jam e gatshme që t'ju trajtoj të gjitha, rast pas rasti, për sa u përket çështjeve me karakter social, problematikave në shëndetësi dhe çështje të tjera të këtij lloji.

Atëherë, problematikat që realisht kanë pasur një numër shumë të lartë ankesash në institucionin tonë kanë qenë, siç edhe ndër vite me radhë, në seksionin e administratës, ku ato më kryesore kanë pasur të bëjnë me problemet që njerëzit ndiejnë në trajtimin e të drejtave të tyre për pronën, regjistrimin e pasurive të paluajtshme, problematikat që kanë pasur me zyrat e regjistrimit të tyre. Kjo është një gangrenë, është një problematikë, e cila prej vitesh vazhdon të jetë një problem shumë i madh. Në vitin 2017 ka rezultuar se disa Zyra Regjistrimi të Pasurive të Paluajtshme nuk kthenin përgjigje ndaj kërkesave që ne kemi bërë dhe për këtë ka pasur edhe raste që ne kemi marrë ato që konsiderohen masa ekstreme nga Avokati i Popullit, duke kërkuar edhe marrjen e masës disiplinore ose pushimin nga puna të këtyre personave. Fatkeqësisht, për këto rekomandime nuk na është kthyer përgjigje nga institucionet përkatëse, por mendojmë se në çdo rast do të vazhdojmë të bëjmë rekomandimet përkatëse.

Duhet të sqarojmë se kompetencat e Avokatit të Popullit janë ato që quhen *soft power* ose kompetenca të buta. Ne nuk marrim në asnjë rast të drejtë për të vendosur gjoba, për të marrë masë drastike ndaj personave dhe për shkak të kulturës në Shqipëri mendoj se konsiderohemi si institucion me fuqi të dobëta dhe jo si një institucion që ka shumë për të thënë apo ka zërin e vet në zgjidhjen e problematikave të rëndësishme në vend.

Megjithatë, fakti që në mesin e vitit 2017 me anë të një vendimi në Kuvend u miratua krijimi i mekanizmit për ndjekjen e zbatimeve të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, besoj se është një risi dhe një frymë e re për t'u dhënë një rëndësi më të madhe rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit.

Siç e thashë, do të doja ta filloja me çështjen e administratës, që ka pasur edhe problematikat kryesore, por problematikat më të rëndësishme, për sa i përket çështjes së të drejtave të pronës, kanë të bëjnë me moszgjidhjen e problemit të madh për ligjin për trajtimin e pronave që nga viti 2015. Vërtet pati një ndryshim në legjislacion, por sërish nuk rezultoi në zgjidhjen e këtij problemi. Një nga qëllimet e ligjit, edhe në momentin që është bërë ligji, ka qenë që ky proces duhet të përfundonte sa më parë. Ne vazhdojmë të jemi në të njëjtën situatë për trajtimin e kërkesave nga ana e komisionit për trajtimin e pronave. Në mënyrë të vazhdueshme ata nuk dalin me vendimmarrje për 11 mijë kërkesat që janë paraqitur më parë në atë institucion. Pra, nuk është ulur numri i ankesave, përveç problematikave që realisht ka ai ligj.

Në këndvështrimin e të drejtave të njeriut dhe të Avokatit të Popullit ne kemi bërë edhe një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila e ka marrë parasysht pjesërisht. Ndërkohë, për dy çështjet nuk është arritur kuorumi dhe nuk është marrë një vendim, por ne kemi gjithmonë të drejtën që në momentin që Gjykata Kushtetuese do të jetë e plotësuar me numrin e anëtarëve, ta paraqesim sërish. Pra, nuk është një kërkesë e rrëzuar, por nuk janë shprehur për shkak të mosarritjes së kuoromit të duhur.

Probleme thelbësore kanë vazhduar të mbeten problematikat me ALUIZNI-n.

Për sa i përket vitit 2017 ka ankesa të shumta për zbatimin e ligjit nga ALUIZNI. Një problematikë që ne kemi vënë re, shumë e mprehtë, është edhe fakti i ndryshimit të sjelljes së administratës shtetërore nga fillimi deri në përfundimin e procesit. Secili prej nesh mendon se është një proces administrativ që ka filluar në një moment të caktuar dhe janë hapa të caktuar administrativë që duhet t'i ndjekë çdo qytetar. Në momentin kur parcela ndërtimore për një iks individ ka kaluar me vendim të Këshillit të Ministrave, si parcelë ndërtimore në favor të individit, nuk mund të ketë kthim mbrapsht të procesit të legalizimit. Fatkeqësisht, ky rast ka ndodhur. Pra, megjithëse ka pasur vendim të Këshillit të Ministrave, ku është kaluar parcela ndërtimore, ka pasur edhe raste ku pronat kanë paguar çmimin për tokën për procedurën e trajtimit për efekt të legalizimit të këtyre banesave, ka ndodhur që ALUIZNI u ka kthyer përgjigje negative. Kthimi i një përgjigjeje negative do të thotë se ka një vendim administrativ që del në kundërshtim me një

vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastin konkret kjo është realisht një problematikë shumë e madhe për sa u përket kompetencave.

Kur e kemi evidentuar në këtë rast, përveç ankesave? E kemi evidentuar në kuadër të disa shpronësimeve që u bënë në rastin e Shkozës, që u konsideruan apo u kryen vetëm për personat që kishin tituj pronësie në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ndërsa personat e tjerë, që e kishin marrë me vendim të Këshillit të Ministrave parcelën ndërtimore, e kishin paguar çmimin, por nuk ishte bërë ende regjistrimi në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nuk u përfshin në VKM-të e shpronësimit. Kjo çështje është realisht delikate për sa u përket problematikave të njeriut dhe sjelljes që duhet të kenë rast pas rasti organet shtetërore për të drejtën e pronës.

Një problem tjetër, që unë e gjykoj nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, është sjellja që kanë organet e Drejtorive të Transportit dhe të Rrugëve, që merren me shpronësimet. Në gjykimin tim janë institucione që nuk zbatojnë në mënyrë tërësore parashikimet e ligjit për shpronësimet në këto raste.

Ka pasur raste që ne i kemi marrë në konsideratë, janë trajtuar një sërë personash dhe vet shteti thotë... Ne duam që secili prej jush, pavarësisht gjendjes faktike, mekanizmat që evidentojnë dhe ligji parashikon... Mekanizmi kryesor është që unë duhet të marr informacion nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Ndërkohë, është fakt i njohur botërisht se Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk e kanë përfunduar procesin e regjistrimit fillestar të pronave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Është detyrë e shtetit t'u garantojë qytetarëve regjistrimin e pronës së tyre. Është një nga detyrat e tyre funksionale që të bëjnë të mundur që çdo sipërfaqe të ketë garanci se cili është pronari. Ky është qëllimi i Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Duke qenë se në disa vende, si rasti i Himarës apo i Shkozës, nuk ka pasur emra për individë, që mund të kenë pasur një sipërfaqe të caktuar, por personat kanë jetuar aty para vitit '91 e më tej, janë konsideruar sikur nuk ekzistojnë, sikur nuk janë aty dhe nuk ka vendime shpronësimesh, është konsideruar çështje shtet dhe nuk janë bërë vendimet e shpronësimit.

Ne kemi një rekomandim, që mendojmë se duhet të trajtohet nga Komisioni i Ligjeve, duke qenë se është edhe një nga komisionet më të rëndësishme, dhe për më tepër komisioni ku ne raportojmë, që në kuadër të vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për çështje të ngjashme, të identifikohen dhe të kategorizohen në ligjin për shpronësimet edhe kategoritë ku

vërtet marrëdhënia me tokën mund të mos ekzistojë në formën përfundimtare, sipërfaqja e tokës mund të jetë shtet, por kanë godinën në kuadër të ligjit për legalizimet, që mund ta kenë bërë sipas këtij ligji, ose janë godinat e vjetra para vitit '91 dhe ka një vendim të Këshillit të Ministrave se si duhet t'i regjistrojnë bashkitë rast pas rasti për këtë çështje. Fakti që pushteti lokal nuk e bën këtë gjë, nuk do të thotë se individët nuk janë pronarë të atyre banesave.

Për këto raste, në gjykimin tim, duhet që në ligjin e shpronësimeve të ketë një kategori të posaçme, që këta individë të mund të marrin ndoshta një përqindje më të vogël të çmimit se sa do të merrnin personat që do të kishin të regjistruar në emër të tyre edhe sipërfaqen e tokës, edhe sipërfaqen e banesës. Kjo do të zgjidhte një problem shumë të rëndësishëm, qoftë nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, sepse qëndrimet e GJEDNJ-së në lidhje me këtë çështje janë të tilla.

Nëse shteti ka lejuar një person që të ndërtojë një banesë dhe ky njeri ka jetuar në këtë banesë për një periudhë të gjatë kohore, ku ka paguar faturat e energjisë elektrike, faturat e ujit, atëherë shteti ka për detyrë që t'ia shpronësojë banesën. Pra, shteti atë banesë nuk mund ta fusë në kuadrin "të paligjshme", për më tepër kur prishmëria që numri më i madh i këtyre personave do të përfitojë nga ligji i legalizimeve, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2004, pra para 14 vjetësh. Unë mendoj se kjo është një zgjidhje, që realisht mund t'i jepte përgjigje një numri shumë të madh të kërkesave dhe problematikave që ne mund të kemi.

Nga ana tjetër, një problem shumë i rëndësishëm për sa u përket çështjeve të shpronësimeve, është se në asnjë prej rasteve të verifikuara lidhur me procedurat e shpronësimit për një projekt të caktuar nuk janë bërë analiza nga ana e drejtorisë përkatëse në Ministrinë e Transporteve. Marrja e pronës private është e vetmja mënyrë për të arritur qëllimin publik. Ky është një kusht paraprak i ligjit. Ligji thotë se prona private mund të merret për të kryer një investim publik vetëm në rast se realizimi i interesit publik nuk mund të kryhet në një mënyrë tjetër, që nuk do të prekte pronën private. Kjo lloj analize tashmë është harruar prej të gjithëve dhe nuk shënohet në asnjë prej relacioneve që dërgohen rast pas rasti në kuadër të shpronësimeve.

Për të kaluar në një tematikë tjetër...

Ulsi Manja - Të lutem, zonja Ballanca!

Deputetët e kanë mbi tavolinë raportin dhe përmbledhjen e bërë nga Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit, kështu që do t'ju lutesha ta përmbyllnit fjalën tuaj, sepse kolegët mund të kenë pyetje dhe diskutime. Ky komision do të miratojë edhe një projektrezolutë për Kuvendin, aq më tepër që ju do të relatonit edhe në seancë plenare.

Erinda Ballanca - Dakord!

Nëse është e mundur do të doja të flisja edhe për disa problematika në lidhje me burgjet dhe policinë.

Ulsi Manja – Në rregull, por shumë shkurt.

Erinda Ballanca - Një nga çështjet e tjera që ne kemi trajtuar, si dhe një punë shumë e madhe që po bën institucioni i Avokatit të Popullit është monitorimi i të gjithë sistemit penitenciar në Republikën e Shqipërisë, gjithashtu edhe i komisariateve. Problematikat që ne kemi ndeshur kanë të bëjnë me kushtet e sistemit penitenciar dhe të burgjeve. Fatkeqësisht, pavarësisht investimeve të rëndësishme, që janë bërë në një numër të madh burgjesh, ka ende burgje, të cilat janë në një situatë vërtet të keqe. Gjithashtu, të drejtat e të burgosurve në këto burgje nuk respektohen, në mënyrë të veçantë nuk respektohen të drejtat e tyre për hapësirat që ata duhet të kenë rast pas rasti. Kemi kushte mbipopullimi, ka problematika të rëndësishme në lidhje me sigurimin e medikamenteve, sigurimin e shtrojave, për të mos folur pastaj për problemin më parësor, që është riintegrimi i këtyre personave. Qëllimi kryesor i sistemit penitenciar nuk është vetëm që këta persona të vuajnë dënimin në burgje, por në gjykimin tonë është që këta persona të mos rikthehen përsëri në burgje.

Një problematikë shumë e madhe paraqitet në lidhje me stafet, të cilat duhet të krijohen nga këto institucione penitenciare, për të bërë të mundur hapjen e kurseve për marrjen e një zanati, në mënyrë që këta persona në të ardhmen të mos u kthehen përsëri situatave të këqija.

Problematika tjetër është se në qoftë se të dënuarit punonin brenda institucionit, sipas programeve bazë, shpërblimi për punën që ata do të kryenin nuk do të ishte vetëm me ulje të dënimit, por edhe me pagesë. Megjithëse ligji ka hyrë në fuqi prej 12 vjetësh, nuk është miratuar ende VKM-ja për këtë gjë. Pra, megjithëse ligji këtë gjë e ka parashikuar në mënyrë të qartë, Këshilli i Ministrave prej 12 vjetësh, duke u nisur edhe nga ministria përkatëse, nuk ka bërë asnjëherë përcaktimin e vlerës monetare që të dënuarit do të përfitonin në rast se do të kryenin punë brenda institucionit. Në gjykimin tonë kjo është një shkelje shumë e madhe e legjislacionit në fuqi.

Kemi disa probleme shumë të rëndësishme në lidhje me qendrat e mbyllura. Ne kemi bërë një rekomandim lidhur me problematikat që kanë personat e sëmurë mendorë, të cilët vuajnë dënimin. Ky është një problem shumë i madh, sepse duhet krijuar një institucion i posaçëm dhe i specializuar për ta dhe këtë kërkesë ne e kemi bërë ndër vite. Ato që unë po them këtu me 5 fjali,

ne i kemi shkruar në shumë faqe dhe në shumë rekomandime që kemi bërë, por unë jam duke tërhequr vëmendjen vetëm për ato probleme që realisht, në gjykimin tim, janë të patejkalueshme për sa u përket problematikave që ne kemi.

Cilësia e mjekëve në këto qendra për të sëmurët mendorë lë shumë për të dëshiruar, sepse nuk ka mjekë. Shkak është bërë pagesa, që është shumë e vogël, dhe asnjë mjek nuk ka interes për të shkuar. Gjithsesi, shteti duhet ta zgjidhë këtë problem dhe duhet t'u krijojë kushtet mjekësore këtyre të sëmurëve mendorë me mjekët e duhur, që t'u japin atyre ndihmën e parë.

Në bazë të rekomandimeve tona burgu i Zaharisë, që ishte më problematiku në vend, do të mbyllet dhe shpresojmë që të bëhet rikonstruksioni tërësor i tij.

Një problematikë tjetër ka të bëjë me mjekët psikiatër, të cilët mungojnë në mënyrë tërësore, sepse për shumë vjet nuk ka pasur specializime në lidhje me këtë kategori. Ne i kemi dërguar një rekomandim edhe Ministrisë së Shëndetësisë, shpresoj ta kem paraqitur edhe këtu, që të bëhet hapja e kuotave për mjekë specializantë psikiatër, sepse në këtë fushë nuk ka mjekë të tillë, për të dhënë kujdesin mjekësor për personat me sëmundje mendore. Kjo është për sa i përket çështjes së burgjeve.

Për sa i përket çështjes së komisariateve, një pjesë e rekomandimeve të dhëna prej nesh janë realizuar, megjithatë vazhdojnë të kenë probleme, në mënyrë të veçantë, në lidhje me cilësinë e kamerave të sigurisë dhe me vendosjen e këtyre kamerave në ambiente të posaçme, sepse për ne është shumë e rëndësishme çështja e parandalimit.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka parimin e tij për parandalimin shkeljes së të drejtave të njeriut dhe për më tepër identifikimin e fajtorëve apo penalizmin e fajtorëve. Sigurisht që fajtorët duhen penalizuar, por në kuadër të parandalimit të problematikave të mundshme pikërisht ekzistenca e këtyre kamerave të sigurisë në komisariate do të bënte të mundur që të evitoheshin problematikat e dhunës, të mos kishte raste dhune nëse do të kishte, apo të dilte e vërteta në ato raste që mund të pretendohen si raste dhune. Në fakt, nuk kanë qenë raste dhune. Jo në pak raste ne kemi pasur, si institucion, ankesa në lidhje me rastet e dhunës, kemi dërguar ekipe dhe nuk kanë rezultuar si të tilla. Pra, në përgjithësi do të duhet jo vetëm parandalimi, gjetja e mekanizmave për të vënë edhe ata punonjës, të cilët duhet të bëjnë punën e tyre në mënyrën e duhur, por duhet t'i monitorojmë vazhdimisht, në mënyrë që të mos kemi problematika, që plasin vetëm atëherë kur ato bëhen mediatike.

Më duhet të them që mediet sociale dhe mediet në përgjithësi janë ndër konkurrentet më të forta të institucionit të Avokatit të Popullit, por edhe të platformës së bashkëqeverisjes, sepse duke njoftuar raste dhune në mënyrat e tyre, sigurisht, ata i bëjnë një shërbim të madh publikut për identifikimin e problemeve aty ku ndodhen. Por, nga ana tjetër, më duhet të them se duhet një vëmendje shumë e madhe e secilit prej nesh, që, në rastin e marrjes së rekomandimeve, t'i kryejmë ato detyra rast pas rasti, sepse, nëse nuk i kryejmë, do të kemi probleme edhe më të mëdha. Për shembull, në rastin e Vlorës, ne kishim vite që thoshim që ka dhunë në atë institucion dhe kemi pasur rekomandime që prej një viti.

Çfarë ndodhi? U gjetën problematika vetëm atëherë kur u bë mediatic. Kështu që do të duhet që secili prej nesh të ketë një përgjegjshmëri më të madhe në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe të rekomandimeve të tjera në përgjithësi. Nuk e them vetëm për institucionin tonë, për të krijuar, për të vazhduar dhe për të mbështetur atë besimin e qytetarëve, i cili, me sa duket, nuk është më në kahun e qeverisë. Pra, secili prej tyre, nuk po flas për qeverinë si maxhorancë, por për ato që janë organe qeverisëse, duke futur edhe veten, është në çdo rast në një presion shumë të madh për çdo problematikë që ndodh, saqë pyesin çfarë po bën Avokati i Popullit. Pra, ka një mungesë të madhe besimi, të cilën ne duhet ta rikuperojmë, por kjo bëhet vetëm duke pasur frymë të re. Në rast se nuk kemi buxhete të mjaftueshme për t'u ardhur në ndihmë këtyre njerëzve, por të kemi një frymë që, të paktën, ata ta ndiejnë se zëri i tyre dëgjohet.

Më shumë dhimbje po e mbyll këtu, sepse kisha shumë gjëra të tjera për të thënë, por duhej ta përmblihdja.

Ulsi Manja – I kanë lexuar deputetët, pa merak, se i kanë mbi tavolinë.

Faleminderit, zonja Avokate e Popullit!

A ka pyetje?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Avokate e Popullit për ekspozenë që bëtë!

Edhe unë me shumë dhimbje do të bëj 4 -5 pyetje, pasi nuk jam shumë i qartë dhe dua që të sqarohem më mirë.

Nga 4546 ankesa që janë trajtuar në vitin 2017, dua të di numrin e rasteve kur Avokati i Popullit ka ndërhyrë vetë. Ju folët gjatë këtu dhe vlerësuat platformën e bashkëqeverisjes si një çështje që kjo qeveri e ka bërë për herë të parë dhe përkon me ardhjen tuaj në krye të Avokatisë së

Popullit, e cila ju ndihmon, siç e thatë vetë, që, në këtë platformë bashkëqeverisjeje të merrni iniciativën, si Avokate e Popullit për shumë raste. A ka raste kur ju keni marrë iniciativën për të trajtuar çështje të caktuara?

Së dyti, në ligjin tuaj, në nenin 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” edhe në ndryshimet që janë bërë, ka një pikë ku thuhet se për shkelje të rënda të vëna re Avokati i Popullit i propozon çdo organi dhe Kuvendit, shkarkimin e funksionarëve që janë kompetencë e tyre. Gjatë vitit 2017 a keni konstatuar ju ndonjë rast të tillë dhe a keni marrë iniciativë për të marrë masa për shkelje të rënda të kësaj dispozite ligjore?

Së treti, ne kemi disa komisionerë të tjerë që vijnë dhe raportojnë këtu si ju, dhe unë doja të dija si ka qenë raporti juaj me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (ankesat vijnë edhe të ju) dhe si ka qenë ky bashkëpunim mes komisionerëve?

Së katërti, ju në raport konsideroni dhe konstatooni se gjeografia e shpërndarjes së ankesave është rritur në krahasim me vitin 2016. Unë dua të di sa eficiente janë dhe kanë qenë zyrat rajonale të Avokatit të Popullit nëpër bashki në përputhje me këto ankesa? Ka qenë eficient, apo, sipas raportimit që ju bëtë, meqenëse këto zyra rajonale kanë ikur nga qendra në periferi, numri i ankesave ka rënë dhe nuk janë efektive? Në funksion të kësaj, do të thosha që do të ishte më e saktë që ai projekti danez, i cili ka përfunduar, të zbatohet në kuadrin e buxhetit të shtetit për të bërë disa zyra rajonale në katër rajone, se edhe qeveria po punon me zyrat e zhvillimit rajonal. Po të kemi katër zyra rajonale të Avokatit të Popullit, mbase do të ishte më mirë t’i kishim funksionale, me fond page dhe të ishin në funksion të Avokatit të Popullit për ta bërë punën e tyre më mirë.

E fundit fare që kam, që ju nuk e prekët, por prekët problematikën e tyre dhe kjo tregon që ju jeni e mirinformuar dhe po punoni për to, ju e dini që Kuvendi i Shqipërisë në muajin mars të vitit 2018, nuk miratoi tri nga komisionerët tuaj, sepse jua ka lënë juve, si Avokate e re e Popullit, që keni filluar gjatë këtij viti, seksionin e organeve të administratës qendrore dhe pushtetit vendor, seksionin për policinë, Shërbimet Sekrete të Burgjeve dhe seksionin e përgjithshëm. Ju aktualisht, duhet të bëni propozimet tuaja për t’i sjellë në Kuvendin e Shqipërisë. Ka që në muajin mars që është rrëzuar nga Kuvendi, edhe më kërkesën tuaj. Do të doja të dija se kur do të bëhen efektive tri komisionerët për të qenë prezent në Avokatin e Popullit?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja avokate.

Erinda Ballanca - Për sa u përket rasteve me iniciativë, dua të sqaroj që për vitin 2017 kanë qenë 114 raste. Cilat janë rastet me iniciativë për Avokatin e Popullit? Janë ato raste në të cilat ne nuk kemi ndonjë ankesë nga ndonjë qytetar, por nga informacionet që ne marrim nga media, shtypi, nga miratimi i ligjeve të caktuara, i konsiderojmë si problematika, për sa i përket çështjes së të drejtave të njeriut. Kështu që ne i nisim dhe i hetojmë vetë.

Në lidhje me bashkërendimin që ne, si Avokat i Popullit na jepet për të përdorur platformën e bashkëqeverisjes, mendojmë se kemi mekanizmat tanë të drejtpërdrejta dhe nuk mendoj se jemi një nga aplikuesit në platformën e bashkëqeverisjes, sepse rast pas rasti ligji ka përcaktuar detyrimin e të gjitha organeve shtetërore që të na përgjigjen drejtpërdrejt vetë. Ajo që mund të them, për sa i përket çështjes se pse e vlerësova çështjen e platformës së bashkëqeverisjes është se ka pasur qëndrime dhe mendime të ndryshme në lidhje me këtë platformë.

Ka pasur mendime dhe qëndrime, të cilat thonë se është një zëvendësim i rolit të Avokatit të Popullit. Ajo që unë si Avokat i Popullit mendoj, është se nuk ka rëndësi për mua nëse krijohen organe të tjera, të cilat u vijnë në ndihmë qytetarëve. Për mua ka rëndësi që problematikat që ka populli të zgjidhen.

Cili është momenti në të cilin ne do të kemi një zgjidhje të këtyre problematikave? Kur punonjësit e administratës shtetërore, kur u shkon një qytetar për të zgjidhur një hall, të mos mendojnë se po i bëjnë nder qytetarit, por të mendojnë se janë duke bërë detyrën e tyre dhe atëherë do të ketë funksionuar edhe platforma e bashkëqeverisjes, edhe institucioni i Avokatit të Popullit.

Në këtë kuadër unë mendoj se rastet që ne kemi marrë me iniciativë janë rreth 114 dhe i bie që janë, pak a shumë, 1 rast në çdo 3 ditë, pra nuk është një numër i vogël rastesh. Megjithatë, duhet ta dimë se në institucionin tonë ka gjithsej 21 persona, të cilët merren me trajtimin e këtyre ankesave, se duket sikur historia e Avokatit të Popullit ka një numër të madh personash, një buxhet, ka një ushtri të tërë që merret me këto problematika.

Këto persona merren me trajtimin e ankesave, me monitorimin e konventave, me promovimin e të drejtave të njeriut, me bërjen e komenteve për ligjet, me marrjen pjesë në aktivitetet ndërkombëtare, me përditësimin në lidhje me gjithë problematikat, me informacionin se ku po shkojnë të drejtat e njeriut në botë, pra janë vetëm këto 21 persona që merren, plus 4 persona që merren rast pas rasti, 5 komisionerët dhe Avokati i Popullit, në total. Ky është numri total i personave që u duhet dhe u bie barra të bëjnë gjithë këtë punë.

Ajo që unë kam dashur dhe që e kam kërkuar (e kemi diskutuar edhe bashkë në parlament, zoti Fino) është shtimi i numrit të personave, të cilët duhet të jenë analistë të çështjeve ligjore dhe realisht të përgatisin materiale, të bëjnë studime, të evidentojnë problematikat për të zbatuar ato që janë standardet më mira të të drejtave të njeriut.

Kjo ka qenë kërkesa që unë kam bërë në mënyrë të vazhdueshme, sepse ky institucion që ne kemi, me gjithë se në vitin 2014 u ndryshua ligji dhe ia dha në mënyrë të posaçme edhe promovimi i të drejtave të njeriut si një nga kompetencat e institucionit, nuk ka brenda vetë institucionit, në strukturë, persona që merren drejtpërdrejt me këtë gjë dhe, pavarësisht dëshirës dhe vullnetit tim shumë të madh që ta bëj natën ditë dhe të punoj sa më tepër, fatkeqësisht, koha është ajo dhe nuk arrijmë dot t'i plotësojmë pritshmëritë e qytetarëve.

Pyetja e dytë ka të bëjë me propozimet që kemi pasur ne si institucioni i Avokatit të Popullit për të marrë masa në lidhje me shkarkimin e personave të caktuar. Në qoftë se ata nuk e kanë bërë detyrën.

E vërteta është se ky është një ndër ato nene që është konsideruar si një nga kompetencat dhe të drejtat ekstreme, përdorimi ekstrem i këtyre rasteve, siç e thashë edhe për vetë natyrën e institucionit.

Institucioni ynë nuk është një institucion, i cili e gjen te përballja apo te problematika zgjidhjen e çështjeve, por është një institucion, i cili ka më tepër rol dhe frymë morale, pra është një institucion, i cili ka një vlerë morale, të cilën të gjithë aktorët mundohen t'ia japin këtij institucioni, sa herë do t'u duhet për t'u ardhur në ndihmë për një "x" apo "y" problem, thonë se ky është qëndrimi i Avokatit të Popullit në lidhje me këtë çështje dhe kompetencat që ata kanë janë shumë të kufizuara në lidhje me marrjen e masave represive.

Është një institucion që funksionon shumë pak respektivisht, megjithatë në vitin 2017 ne kemi pasur 5 raste në të cilat kemi kërkuar marrje masash disiplinore dhe shkarkim të punonjësve për mosrealizimin e detyrave të tyre funksionale, raste të cilat kanë qenë të gjitha pa përgjigje. Nuk kemi mekanizëm tjetër, veçse të raportojmë në një organ më të lartë dhe të themi se ky veprim nuk u krye apo ka pasur raste edhe në vijimësi, edhe këtë vit kemi të tjera, raste në të cilat personat nuk kthejnë përgjigje.

Kemi pasur, gjithashtu, një sërë rastesh, të cilat janë masa drastike të raportimit, të bërjes së kallëzimeve penale dhe raportimit pranë organit të prokurorisë të personave, të cilët kanë shkelur rast pas rasti ligjin, prokuroria ka qenë në gjykimin tonë, sidomos në rastet e dhunës ndaj

fëmijëve dhe të keqtrajtimit të tyre, ka qenë shumë e hapur dhe në fakt këto rekomandime që ne kemi bërë kanë nisur çështjet penale dhe çështjet janë duke u gjykuar.

Për sa i përket çështjes së raporteve dhe marrëdhënieve me Komisionerin për Informimin dhe me Komisionerin kundër Diskriminimit, unë mendoj se ne kemi pasur raporte shumë të mira institucionale me të dy këta komisionerë. Mund të flas që nga momenti kur kam marrë detyrën, por besoj se edhe raportet e paraardhësit tim kanë qenë të mira. Nuk kam pasur ndonjë shqetësim nga ana e tyre në lidhje me raportin dhe marrëdhënien që unë kam, qoftë me zotin Dervishi, qoftë me zotin Gajda. Ato janë marrëdhënie të shkëlqyera.

Kemi bërë të mundur edhe nënshkrimin e një memorandumit me zotin Drevishaj për detyrat dhe kompetencat përkatëse ose bashkëpunimin. Një memorandum të ngjashëm do ta nënshkruaj edhe me Komisionerin Kundër Diskriminimit në datën 28 maj. Kjo për arsye se u mendua që të pritej komisioneri i ri dhe të mos e vinim para faktit të kryer, për sa kohë komisionerit tjetër i kishte mbaruar mandati. Mund të them se ishte një vlerësim i bërë nga të dyja palët, prandaj do të ishte më mirë që në momentin në të cilin zonja Baraku ishte në përfundim të detyrës, nuk kishte vend që ajo të firmoste një memorandum bashkëpunimi, prandaj do të ishte më mirë që ta firmoste kur të vinte komisioneri i ri, me vullnetin e vet.

Për më tepër, lidhur me zyrat rajonale ne kemi një ide, e kam pasur më parë edhe me zonjën Baraku, por tani e ka mbështetur shumë edhe zoti Gajda që të mundohemi të maksimalizojmë buxhetet dhe të vëmë në eficiencë ato çështje që i kanë të dyja institucionet.

Ka qenë një propozim dhe ndoshta bëhet pjesë e këtij memorandumit, por kjo do të kërkojë edhe vullnetin e Kuvendit, se duke qenë që edhe ata kanë hapur disa zyra rajonale në kuadrin e projektit antidiskriminim, që është një gjë shumë pozitive, të mundohemi të mos i dublojmë zyrat, pra në ato vende ku ka zyra institucioni i Avokatit të Popullit, ne të mbështesim edhe komisionin e ri të antidiskriminimit. Le të jenë zyra të përbashkëta dhe të rrisim numrin e prezencës nëpër rrethe. Pra, në qoftë se i kemi veç në rajone të caktuara, vetëm në Shkodër i kemi të dy bashkë. Të tjerat të mundohemi që aty ku kanë ata, të mos kemi ne dhe funksioni të jetë, ai person që është part – time, i cili do të punojë në këtë institucion, të kryejë edhe marrjen e ankesave, për sa i përket çështjes së rasteve të antidiskriminimit ose të Avokatit të Popullit. Sqaroj se zyrat e Avokatit të Popullit nëpër rrethe, të paktën tonat, bëjnë vetëm marrjen e aplikimeve nga qytetarët, duke i këshilluar ata rast pas rasti, nëse është apo s'është vendi, por ama trajtimi i rasteve dhe

vendimmarrja, kuptohet, bëhet në zyrat qendrore. Në rastin konkret, mendoj se kjo do të jetë një gjë pozitive, duke shkuar sa më pranë qytetarëve.

Këtu më duhet të bëj një retrospektivë dhe të them se institucionet e të drejtave të njeriut, në nivel ndërkombëtar, rankohen në shkallë të ndryshme. Fatmirësisht, institucioni i Avokatit të Popullit ka atë që quhet rang A, pra është në nivelin më të lartë të institucioneve, për sa u përket parametrave, kompetencave dhe punëve që ka në lidhje me problematikat që trajton e rekomandimeve që bën, duke u barabatur me vendet e tjera.

Ky është një rishikim, i cili kryesisht bëhet edhe mbi bazën e buxheteve, zoti Fino, e në lidhje me këtë do të doja vërtet vëmendjen tuaj. Pra, verifikohet dhe shikohet se sa buxhet jep çdo shtet për institucionet e të drejtave të njeriut, sa vlerë kanë, sa u zbatohen rekomandimet. Pra, ka disa parametra, të cilat vlerësohen rast pas rasti nga Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut. Edhe në Kombet e bashkuara ka një strukturë të posaçme lidhur me këtë çështje.

Vitin e ardhshëm, në Shqipëri do të ketë një rishikim të veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit dhe do të bëhen disa verifikime. Ne e kemi kaluar para katër vjetësh këtë proces, por do ta rikalojmë edhe tani. Në atë vit, një nga pikat që u shty, rikonfirmimi i statusit “A” të Avokatit të Popullit të Shqipërisë, kishte të bënte me faktin e hapjes së zyrave rajonale. Prandaj, unë e çmoj shumë faktin që Kuvendi i Shqipërisë ka vlerësuar t’i hapë ato zyra rajonale, të cilat duhet t’i mbajmë e t’i forcojmë, duke u munduar të gjejmë realisht edhe rrugë të përbashkëta me Komisionerin Kundër Diskriminimit, në mënyrë që të vazhdojmë të tregojmë vlerën dhe rëndësinë që qeveria dhe parlamenti në Republikën e Shqipërisë i jep të drejtave të njeriut, për ta riakredituar si institucion me status “A”.

Më duhet të them se përsëri do të mbetet problematike çështja e buxheteve. Shqipëria ka 30 % më pak punonjës se Kosova në institucionin e ombucmanit, gjysmën e buxhetit që ka në Kosovë. Kjo për të njëjtat institucione. Prandaj duhet bërë një punë pak më e madhe në lidhje me këtë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Numri i Avokatit të Popullit ka të bëjë me numrin e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, me mikrofon, zoti Fino!

Bashkim Fino – ...e trajtimit, dhe nuk mund t’i marr dot kurrë ato që ka kolegu im në Bundestagun gjerman.

Erinda Ballanca – Po ne nuk po kërkojmë fondet e Gjermanisë.

Bashkim Fino – Që do të thotë se ne duhet t'i marrim gjërat në kompleksitet. Unë jam absolutisht dakord me zyrat rajonale, që duhen forcuar. Ajo që thatë ju ishte shumë e bukur: të bëhen bashkë me zyrat e Komisionerit Kundër Diskriminimit, t'i hapim si zyra, të keni zyrat tuaja, e mundësisht të ketë nga dy punonjës: një të jetë juaji, një të jetë i Komisionerit Kundër Diskriminimit, por të paktën të jenë zyra që rrinë non stop të hapura, me qëllim që qytetari, në një çast të caktuar të shkojë aty, duke e ditur se është atje një njeri që e mbron nga diskriminimi. Këtë duhet ta bëjmë patjetër, se keni dy projekte: qoftë ju me danezët, qoftë ata...

Erinda Ballanca – Ne s'kemi më projekt.

Bashkim Fino – Jo ju, por qoftë ju që e nisët me danezët, them, dhe e përfunduat, qoftë Komisioneri Kundër Diskriminimit.

Erinda Ballanca – E kanë përfunduar edhe ata.

Bashkim Fino – E kanë përfunduar edhe ata.

Duhet ta shikojmë në këtë buxhet, që të bëjmë katër zyra rajonale: Tiranë – Shkodër – Korçë – Vlorë.

Erinda Ballanca – Katër janë pak; ne kemi shtatë momentalisht. Ne themi ta rrisim.

Bashkim Fino – Mirë, mirë, unë them katër të jenë të certifikuara, e kupton, me fonde e me të gjitha, pra të mos kenë asnjë lloj problemi. Pastaj, ti mund të hapësh edhe në çdo bashki, janë 61 bashki.

Erinda Ballanca – Ne kemi shtatë momentalisht.

Bashkim Fino – Po mos ma merr shembullin me ekuacion, të lutem, se i bie të diskriminohemi ne, dhe unë jam kundër diskriminimit.

Erinda Ballanca – Unë e mora shembullin me Kosovën, nuk e mora me Gjermaninë apo me Francën.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja avokate!

Zoti Qefalia, të kërkoj ndjesë, se duhej t'ia kisha dhënë që në fillim fjalën relatores, zonjës Xhina. Ose ta lëmë në fund, që të bëjë një ekspozë.

Po, zoti Qefalia, pyetje.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Avokate e Popullit!

Në fakt, më vjen mirë që gjëja u fut në normalitet. Më ka bërë shumë përshtypje, se duket sikur i paraprin kësaj, por duke lexuar parathënien e raportit tuaj analitik, që jam shumë i kënaqur për mënyrën se si e keni shkruar, e gjej rreth 52 herë fjalën “gjuha e urrejtjes”. Në fakt, ju e patë edhe sot se çfarë ndodhi. Gjithsesi, nuk po ndalem te pjesa politike, sepse ju jeni Avokate e Popullit dhe s’i përkisni, pavarësisht subjektit që ju ka propozuar.

Unë kisha tre pyetje: së pari, e kam shumë mirë parasysh se Avokati i Popullit nuk është zgjatim i pjesës shtrënguese të shtetit, por funksionon në bazë të rekomandimeve që jep. Kjo pyetje përkon me atë që bëri edhe kolegu Fino: a keni një numër faktik, një numër ekzakt, pra sa është numri i personave që ju keni propozuar për masë disiplinore? Sa është, faktikisht? Për shkelje, për konstatime që ju keni bërë.

E dyta, ju thoni se kemi pasur mosrakordime e moskthim përgjigjesh nga disa institucione shtetërore. Cilat janë këto institucione dhe sa është numri i tyre? Ndërkohë, atakoni edhe me Komisionin e Ligjeve, i cili është komisioni përgjegjës për hartimin e mjaft ligjeve e projektligjeve, kur thoni se në asnjë rast nuk jemi thirrur për sa i përket marrjes së mendimit në lidhje me ligjet që kanë të bëjnë kryesisht me respektimin e lirive e të drejtave të njeriut. A keni diçka konkrete në lidhje me rastet që nuk jeni ftuar?

Pyetja e fundit: në raportin dhe në informacionin tuaj... Do të kërkoja vëmendjen tuaj, zonja avokate, se edhe unë jud zgjova juve. Në lidhje me institucionet penitenciare dhe në stacionet e policisë, ju sollët si argument vetëm kushtet, nëse ato janë funksionale, nëse ndërtesat kanë parametrat e duhur për të krijuar ajrimin apo të kushteve, sipas përcaktimeve që janë edhe në Konventën e të Drejtave të Njeriut, por në asnjë rast nuk u ndalët tek çështja nëse nga stafi që shërben në këto institucione bëhen abuzime sa u takon shkeljeve të lirive e të drejtave të njeriut. Këtë konstatim nuk e bëni ngaqë nuk keni pasur komisionerë, nuk e keni ushtruar apo çfarë?

Duke shpresuar në përgjigjet tuaja, mendoj se mund të kemi edhe ndonjë pyetje tjetër.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Qefalia!

Po, zonja avokate.

Erinda Ballanca – Ne, në fakt, kemi bërë një listë të qartë dhe të detajuar e kemi për sa u përket rekomandimeve pa përgjigje apo atyre të pazbatuara. Në qoftë se për një rekomandim nuk kthehet përgjigje, në gjykimin tim është konsideruar si një nga shkeljet më të rënda të ligjit që bëhet nga këto institucione.

Unë kam një listë të plotë për vitin 2017, janë 24 raste, 24 institucione, duke filluar nga kryetari i këshillit të qarkut në Durrës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kryeregjistruesit e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit Gjyqësor, përsëri kryeregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë, siç e thashë ishte një nga gangrenat kryesore, Agjencia Rajonale e Mjedisit, Drejtoria e QSUT-së, Komisarati i Policisë Delvinë, Komisarati i Policisë Sarandë, Komisarati i Policisë Vlorë, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, kryetari i bashkisë Fier, Këshilli Bashkiak Fier, kryetari i bashkisë Himarë, një problematikë shumë e madhe kjo e bashkisë së Himarës, një refuzim total i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, partitë politike, kryetari i KQZ-së, IMT-ja pranë Bashkisë Tiranë, kryeinspektorja e IKMT-së Tiranë, kryetari i bashkisë Vlorë, Ministria e Shëndetësisë, te Drejtoria e Përgjithshme e QSUT-së, Ministria e Drejtësisë, te Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Bashkia Tiranë. Këto janë rastet pa përgjigje për sa u përket rekomandimeve tona, të cilat sipas parashikimit ligjor, duhet të na kthejnë një përgjigje për 30 ditë. Në këto 24 raste, në 5 prej tyre ne kemi kërkuar marrjen e masave për shkarkimin e personave, të cilët janë përgjegjës në lidhje me këto gjëra. Kuptohet kemi marrë edhe masa të tjera, në të cilat nëse ne themi: “për marrjen e masave për gjetjen e përgjegjësive administrative”, vërtet nuk është një rast shkarkimi, por mund të shkojë edhe në shkarkim, rast pas rasti për ato institucione, të cilat i trajtojmë.

Ne kemi edhe një listë tjetër, e cila është me rekomandime të pazbatuara të Avokatit të Popullit, të cilat pranohen. Pra, janë rekomandime që na është kthyer një përgjigje, ku thuhet: “Po, është e drejtë, por nuk kemi fonde për ta zbatuar”. Ky është një nivel tjetër. Në lidhje me këto, sipas punës që kemi bërë, unë bashkë me stafin kemi konsideruar se sivjet do të kalojmë në një fazë, edhe në raportimin e vitit të ardhëm do ta shikoni se do të kemi hetuar apo thelluar dhe më tej ndjekjen e këtyre problematikave. Nëse na thonë: “E pranojmë se duhet të përmirësohet gjendja në filan institucion, por nuk kemi fonde”, duam të shikojmë: a i kanë kërkuar fondet? Nëse po, a i kanë përdorur realisht ashtu siç duhet ato? A kanë bërë mbrojtjen e duhur? Ushtrimi i detyrës nuk është vetëm të themi se nuk kemi lekë për ta bërë këtë gjë, por është që ti të paktën të përdorësh të gjitha mjetet që ke në dorë dhe fuqi, siç po e përdor unë tani me zotin Fino. Unë e di, zoti Fino e do shumë të mirën e institucionit dhe këto janë mundësitë, por e them sepse në mënyrë të vazhdueshme e ka shprehur edhe kur kemi diskutuar buxhetin. Diskutimi është se unë vazhdoj t’ia them, sepse e di që kjo është një çështje procesi. Duhet t’ia them 20

herë për të bërë punën time, duke shpresuar të arrijmë të gjemë një mirëkuptim për ato probleme, të cilat realisht mund të jenë të zgjidhshme. Prandaj them se do të mundohemi që të rritet vlerësimi dhe përgjegjshmërinë edhe të personave në lidhje me këto problematika.

Më duhet të them se ndonjëherë bërja publike e rasteve realisht sjell një frymë më pozitive. Fakti i dhunës, për shembull në Shtëpinë e Fëmijëve në Vlorë ngriti një problematikë shumë të madhe, edhe vetë fakti që ne si institucion kishim bërë një rekomandim në lidhje me atë dhe nuk kishte pasur përgjigje. Tani për çdo rekomandim që bëjmë, nga ana e bashkive marrim përgjigje në lidhje me këto rekomandime. Pra, tregon se janë disa mekanizma që ndoshta kur bëhen publike, herë pas here institucionet e kuptojnë që mund të ketë probleme në një të ardhme në lidhje me x-in apo y-in dhe duket se ka një përgjegjshmëri më të madhe në kthimin e përgjigjeve edhe në rastet kur ata e kanë të pamundur për të pasur një rezultat përfundimtar. Për shembull, rastet e Shkodrës dhe problematikat në shtëpitë e fëmijëve në Shkodër janë vërtet problematika shumë të thella. Kemi bërë realisht ndjekjen e çështjeve penale për personat, por ata vazhdojnë të jenë në punë. Pra, janë nisur çështjet penale dhe ata vazhdojnë të jenë aty, në ato institucione megjithëse është kërkuar dhe është marrë një masë ekstreme.

Pyetja tjetër, për sa i përket çështjes së ligjeve, kjo në fakt është një nga ato gjëra që unë, zoti Qefalia, do të doja shumë ta bëja, pra për rekomandimet rast pas rasti për një sërë ligjesh. Ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë në lidhje me një numër ligjesh dhe nuk kemi thënë: në asnjë rast nuk na kanë marrë mendim. Ne themi: ka edhe raste kur nuk na kanë marrë mendim. Ka raste, nëse na kanë kërkuar mendim, kemi dhënë mendim në disa komisione. Kemi një bashkëpunim shumë të mirë me zonjën Ferhati në lidhje edhe me ligjin “Për ndihmën sociale”, apo për ligjin “Për banesat sociale”, ku janë marrë parasysh qëndrimet e Avokatit të Popullit, por ndërkohë qëndrimet e Avokatit të Popullit nuk janë marrë parasysh për shembull për ligjin “Për tarifën gjyqësore”, që në gjykimin e Avokatit të Popullit...

Ulsi Manja- Më fal! Avokati i Popullit rekomandon, e ke në ligj. Ju mund të bëni shumë rekomandime, jo vetëm në procesin e ligjbërjes, por edhe për të gjitha fushat, ku ligji ju ka dhënë thjesht të drejtën të rekomandoni.

Tani, të gjithë veprojnë brenda ligjit edhe Kuvendi, edhe Avokati i Popullit, gjithçka i nënshtrohet zbatimit të ligjit.

Erinda Ballanca - Më falni! A mund të përgjigjem?

Ulsi Manja – Patjetër që do të jepni përgjigje, por vetëm do t'ju lutesha shkurt, sepse të gjithë kolegët kanë pyetje.

Erinda Ballanca - Nëse përgjigja ime ishte e mjaftueshme, unë mund ta mbyll këtu.

Ulsi Manja- Jo, vazhdoni.

Erinda Ballanca – Përgjigjen që unë kisha për të thënë e thashë, e kisha diku tjetër çështjen.

Ulsi Manja- Nuk ka rëndësi.

Erinda Ballanca – Po, prandaj po ju them, kemi disa raste që nuk jemi ftuar, kemi disa raste ku jemi ftuar. Ajo që po them është bashkë me faktin që ne duhet të kemi njerëz, të cilët të ftohen, sepse më duhet staf, i cili ta bëjë këtë punë dhe ta bëjë atë mirë. E kam shënuar në raport për të pasur një mundësi, për t'i kërkuar mirëkuptimin zotit Fino, që të kemi stafe për të krijuar grupin, bërthamën, promovimin e të drejtave të njeriut. Kjo është çështja. Ne e kemi diskutuar. Kuptohet, në buxhetin e kaluar ishte hera e parë që unë kisha diskutim në lidhje me këtë çështje, prandaj e kam menduar të jetë një nga problematikat që në mënyrë të vazhdueshme ta ngre në lidhje me komisionin.

Për sa i përket çështjes së burgjeve dhe pretendimit të atyre që u diskutuan në lidhje me faktin e MKP-ve, burgjet te ne inspektohen nga dy seksione.

Së pari, nga ai i parandalimit të dhunës. Ky trajton kryesisht kushtet, gjendjen e burgjeve dhe parandalimin. Për cilësinë e stafeve kemi folur në rekomandimet që kemi bërë rast pas rasti, qoftë për cilësinë, për edukimin e tyre të vazhdueshëm, qoftë për cilësinë e mjekëve që janë, qoftë për mungesën e mjekëve dhe gjëra të tjera. Sigurisht ne nuk kemi pasur problematika nga ato raporte, për sa kohë që unë i nënshkruaj vetë, i kam lexuar të gjitha vetë në lidhje me cilësinë e personave që kanë qenë drejtorë të burgjeve. Nuk kemi pasur ndonjë problem në lidhje me këtë çështje. Sigurisht që stafi në tërësi ka pasur. Nga ana tjetër, kemi nxjerrë rekomandime rast pas rasti për secilin burg dhe për secilin komisariat që kemi inspektuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, sepse nuk ka qenë pengesë. Ne mekanizëm vendi ka qenë vakant. Ka pasur një drejtuese mekanizmi, e cila ishte një personat që është marrë në lidhje me këtë punë. Në ndryshimet që ju bënë ligjit drejtuesja e mekanizmit duhej të ishte juriste. Ishte psikologe për shkak se në mekanizmat nëpër botë konsiderohen grupet multidisiplinore. Ajo vazhdoi ta kryente detyrën e saj si anëtarë dhe si drejtuese e mekanizmit deri në momentin kur u emërua drejtuesja e re e

mekanizmit. Sigurisht, shpresoj që puna në lidhje me këtë çështje do të ecë përpara. Ne kemi vetëm një seksion, i cili nuk ka drejtues. Të tjerët janë ata që kanë përfunduar mandatin, që vazhdojnë të kryejnë detyrën, sipas ligjit, deri në momentin kur do të zgjidhen të tjerët.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kush ka pyetje?

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Unë e kam lexuar dy herë me vëmendje raportin. Kuptohet që është një raport që përmban problematika. Plus që kam edhe një detyrim më shumë, sepse me Avokaten kemi një njohje dhe një miqësi të hershme dhe nuk ka pse ta fsheh. Kuptohet që Avokatja mbuloi gjysmën e vitit të kaluar. Nuk do të ndalem shumë në vlerësimet që janë bërë aty.

Avokate, unë kam konstatuar tri problematika, të cilat do të doja t’i ndanim bashkë.

Së pari, unë dëshiroj që, kur të bëhen raportet, duhet të bazohen në rezolutën dhe rekomandimet e dhëna nga Kuvendi vitin e mëparshëm, sepse është një raportim që bëhet në Kuvend, por nuk e gjej këtë gjë në raport. Mendoj se duhet të krijojmë një praktikë që raportet gjithmonë të bazohen në ato detyra që lë Kuvendi, përveç tyre, mund të raportoni çfarë të dëshironi për aktivitetin tuaj, por rezoluta lë detyra në disa drejtime, ku duhet të fokusohet institucioni, sepse edhe Avokati i Popullit është një organ, i cili bën pjesë në strukturën e shtetit shqiptar dhe patjetër që ka disa detyrime ndaj Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë fokus, unë nuk shoh të keni një analizë për rekomandimet që janë dhënë, pra se çfarë janë realizuar dhe çfarë nuk janë realizuar. Për shembull, siç është fakti i plotësimit të strukturës, që ka qenë për vitin e kaluar, i cili nuk është bërë i mundur, ndoshta jo për fajin tuaj, por kjo mund të sjellë edhe problematika në plotësimin e detyrave të tjera.

Së dyti, Avokate, pavarësisht besimit absolut dhe aftësive tuaja profesionale, kam vërejtur në raport, por jo vetëm, disa tejkalime, shpesh të opinionëve të pabazuara në fakte. Patjetër që do të ngrini shqetësime, por në momentin shqetësimet nuk gjejnë mbështetje në fakte, mendoj se edhe Avokati i Popullit duhet të ndalojë aty. Ku e bazoj këtë që them?! Po ju jap disa shembuj dhe do të jap përgjigje për këtë rast.

Për shembull, shqetësimi juaj për tarifat gjyqësore. Ju u gjendët në një front të hapur kundër miratimit të atij ligjit, ndërkohë që i gjithë argumenti juaj ishte që ligji i tarifave gjyqësore i cenonte kategoritë në nevojë, kategoritë vulnerabël. A i keni kërkuar shpjegime Ministrisë apo Kuvendit? Jam i bindur që, po t’u kishit kërkuar, gjë për të cilën dyshoj, Ministria apo Kuvendi do t’ju

tregonin që kemi miratuar edhe një ligj tjetër, ai për ndihmën juridike, të cilin ju e përmendët, që ua zeron fare tarifat këtyre shtresave. Atëherë, cili është shqetësim i Avokatit, kur këto shtresa në nevojë nuk do të kenë fare tarifa, kur dje, edhe pse kishte disa hapësira ligjore, në bashkë e dimë që nuk respektoheshin? Ndërkohë, ne kemi shpjeguar se (pas 6 muajsh hyn në fuqi, në qershor) janë të gjitha mekanizmat që ata ta përfitojnë realisht atë ndihmë, kështu që bie i gjithë argumenti. Lufta juaj e madhe këtu, në këtë frontin kundër, nuk më ka pëlqyer. Në këtë qëndrim ju keni detyrë (nuk duhet të merrni opinionet e gazetave, në fakt, merrini edhe ato) në radhë të parë t’i drejtoheni Kuvendit dhe t’i thoni se keni këto vërejtje, se nuk jeni ftuar, se keni dëgjuar që është kjo situatë lidhur me atë ligji dhe se doni qëndrimin e tij. Keni të gjithë të drejtën ligjore t’i thoni ministrisë propozuese se ku e bazon këtë dhe atë parashikim të ligjit. Nuk me rezulton ta keni bërë edhe këtë gjë. Nëse e kam gabim, mund të më përgjigjeni.

Madje, jo vetëm kaq, përveç tarifave, kam vërejtur në komentet tuaja që flisni për të drejtën e pronës. Ju në faqen 11 jeni shprehur se është antikushtetuese, mund edhe ta citoj. Ju thoni se Gjykata Kushtetuese ju ka dhënë pjesërisht të drejtë. Po të ka dhënë pjesërisht, do të thuash vetëm pjesërisht, sepse është organi më i lartë dhe nuk mund të dalësh mbi Gjykatën Kushtetuese dhe të thuash tani se është antikushtetuese, por se për këtë pjesën ju ka mbështetur edhe Gjykata Kushtetuese. Kaq duhet të thuash, pra aq sa të ka mbështetur Gjykata Kushtetuese, ai është verdikti. Më lart se Gjykata Kushtetuese nuk kemi.

Shoh edhe ndonjë përkufizim, ku jeni edhe më agresivë se institucionet ndërkombëtare. Për shembull, në mos gaboj, citoni përkufizime, që tejkalojnë ndonjëherë edhe Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Mund t’jua citoj, Avokate. Nuk e di ku e bazoni këtë. Për shembull, në faqen 11 thoni: “Vijon të jetë tregues i mosrespektimit të së drejtës së pronësisë dhe i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor”. Edhe Gjykata Europiane, në vendimet e fundit, e ka hequr këtë togfjalësh, sepse, duke pasur prishmëri ndaj shtetit shqiptar për çështjen e ligjit të ri, është duke pritur aplikimin e këtij ligji. Avokati ynë i Popullit del më agresiv se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut! Madje, edhe raportet e Komisionit European janë shumë më pozitive se vlerësimet tuaja. Mendoj se jeni pak në tejkallim opinionesh.

Doni një rast tjetër?! “Organet e policisë”, në faqen 24: “Është mbi popullim i komisariateve për shkak të disa veprave penale të përhapura kohët e fundit”. Në çfarë statistikash e bazoni këtë?! Në statistikën zyrtare nuk na rezulton kjo gjë. Nëse ju keni të tjera... Cilat janë veprat penale?! Më fal, trafikimi apo kultivimi i narkotikëve kanë qenë të përhapura më parë, se

bashkë kemi pasur klientë?! Edhe ky më duket i tejkaluar, ose që merr një spunto të pambështetur në prova dhe fakte.

Të ndihma ekonomike thoni se masa e përfitimit është shumë e ulët. Vitin që kaloi është trefishuar, në krahasim me sa ka qenë. Edhe unë mendoj se është shumë e ulët. Por kur dilni në konkluzionin: “Një masë shumë e ulët e normës së përfitimit”, mund edhe të konstatooni që është trefishuar, por që është ende shumë e ulët. Kjo është e bazuar mbi fakte. Konkluzioni i pjesshëm, duke thënë se është i ulët, më duket tejkalim opinionit.

Së fundit, do të doja një sqarim: LGBTI-së në raport i referoheni herë LGB, herë LGBT dhe herë LGBTI, a ka ndonjë ndarje reale, apo është për shkurtim? Nëse është thjesht kështu, mos e konsideroni si pyetje. Thjesht për njohuritë e mia dua të di nëse ka në aktivitetin tuaj grupime brenda LGBTI-ve, që u referoheni veç e veç. Pra, nëse është çështje shkrimi, mos e konsideroni fare si pyetje.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Ju lutem, në mënyrë të përmbledhur, sepse aty kishte më tepër komente, por nëse ka një përgjigje për ato që tha zoti Hyseni!

Urdhëroni!

Erinda Ballanca – Faleminderit!

Në fakt, kam disa përgjigje, por po e filloj nga kjo e fundit.

Ulsi Manja – Në fakt, aty vetëm një pyetje ishte, jo disa.

Erinda Ballanca – Më tha se kam 5.

Ulsi Manja – Mund të bëni një koment në mënyrë të përmbledhur.

Erinda Ballanca – Në lidhje me rezolutat e mëparshme, viti 2016 nuk ka pasur një rezolutë, nuk është trajtuar, duhet të kishim kaluar te viti 2015, megjithatë do ta kem parasysh për vitin në vijim.

Për sa u përket LGBTI-ve në lidhje me terminologjinë që është përmendur, në fakt, është një gabim i bërë nga ne, sepse në të gjitha rastet ata e ndryshojnë herë pas here emërtimin e grupeve që kanë. Në fakt, tani ata emrin e kanë LGBTIQ, sepse në grupet e tyre kanë futur edhe persona, të cilët janë të pasigurt në lidhje me identitetin tyre gjinor. Por kjo është e drejtë e tyre. Do të më falni që, në kuadër të editimit, nuk e kemi vënë re referencën në lidhje me këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi ndarje grupesh. Por, për sa u përket të drejtave të këtyre personave, ka pasur një trajtim nga ana e institucionit, në atë masë që ju e keni vënë re, dhe nuk besoj se është në një nga ato çështjet, të cilat do të ishte shumë problem, siç e thatë edhe vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo çështje i përket vitit 2018. Unë kam dalë me zë dhe me figurë, e kam trajtuar atë çështje, edhe sot dite marr pafundësisht *hate speech* dhe *hate language* në lidhje me çështjet e LGBTI-së dhe me mbrojtjen e këtyre personave në mënyrë të vazhdueshme. Edhe sot që flasim ka të paktën 10-15 sms në facebook-un tim, në të cilat më urojnë që fëmijët e mi t'i përkasin këtij komuniteti. Kështu që nuk ka asnjë problem, në qoftë se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk janë të pranueshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Hyseni!

Erinda Ballanca – Nuk e kemi monitoruar projektin e ministrisë në vitin 2017 dhe nuk kemi pasur asnjë dijeni për projektin e ministrisë në vitin 2017. Ministria projektin nuk e ka për të mbrojtur LGBTI-në, e ka për luftën kundër bulizmit dhe e vlerësoj shumë atë projekt. Të themi se nëse një nga format e bulizmit, është bulizmi për shkak të identitetit gjinor, kjo ka qenë çështja që ka pasur më shumë komente dhe ka nxehur opinionin publik, duke pasur reagime nga më të ndryshmet, mendoj se ne, si shtet, si shoqëri, duhet të pranojmë edhe njerëzit e ndryshëm për atë që ata janë. Vetëm duke i pranuar, mund të ecim përpara, duke mos i pranuar, mendoj se shkel një të drejtë thelbësore të atyre njerëzve. Nuk duhet t'i diskriminojmë për shkak të identitetit të tyre gjinor dhe këtu përfundon detyra dhe marrëdhënia e Avokatit të Popullit me këtë grup. Pra, në gjykimin tim çdo e drejtë e tyre thelbësore dhe ata diskriminohen, sigurisht ne kemi për të dalë dhe kemi për të folur në lidhje me ato që ata kanë. Kjo për sa i përket kësaj çështje.

Për sa i përket çështjes së tarifave gjyqësore, në fakt, ne kemi pasur komente, të cilat ia kemi përcjellë Komisionit të Ligjeve dhe le të themi se për momentin janë kryer. Zoti Hyseni, përsëri në gjykimin tonë, mendojmë se ato tarifa janë të larta jo vetëm për grupet vulnerabël dhe grupet në nevojë, por edhe për njerëzit normalë dhe për nivelet normale të pagave që janë sot në administratën shtetërore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në lidhje me tarifatat, kemi disa referenca. Personalisht e kam parë atë ligj, dhe realisht ka një vlerë, ka një përqindje për sa u përket atyre...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Si jo? Unë e kam korrigjuar vetë.

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Fino! Ky është një ligj që e ka votuar Kuvendi i Shqipërisë dhe do të hyjë në fuqi në qershor. Kështu që besoj se qëndrimet dhe opinionet për një ligj...

Erinda Ballanca – Në lidhje me paditë me vlerë...

Bashkim Fino – Ajo është tjetër gjë.

Erinda Ballanca – Paditë me vlerë dhe ngritja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e paguan, sepse e paguajnë individët. Në momentin kur firma dhe individi kërkojnë një detyrim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, zoti Fino! Ne do të takohemi përsëri këtu para se të fillojë aplikimi i ligjit. Në momentin që një firmë shumë e rëndësishme i ka paratë dhe e hedh në gjyq qytetarin, atëherë qytetari për të bërë ankimin, pasi e humb gjyqin, duhet të paguajë tarifë me përqindje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, absolutisht! Kështu që ankimi është i shkruar qartë në ligj dhe përqindja është edhe në rastin e ankimit. Pra, është e vërtetë që firma për të cilën po diskutojmë dhe, për mendimin tim, nuk është gjë e keqe që ne të kemi sa më shumë ekonomi tregu të hapur në vend...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, mënyra se si është shkruar ligji... unë shpresoj që ta zbatojnë në këtë mënyrë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, ju lutem!

Erinda Ballanca – Unë kam lexuar ligjin e miratuar, sepse më është dashur të bëj një leksion në Shkollën e Avokatisë dhe për këtë arsye...

Ulsi Manja- Zoti Hyseni, zoti Fino, zonja avokate, ju lutem, nuk dua komente për një ligj që është votuar nga Kuvendi!

Raportimi është tjetër fokus, ai ligj ka hyrë në fuqi dhe do të zbatohet më 1 qershor e mbrapa, në qoftë se nuk gaboj. Kështu ka vendosur ligjvënësi dhe e ka miratuar atë ligj.

Ju lutem, a ka pyetje të tjera? Raportimi është mbi dy orë, kështu që fokusohuni më tepër te pyetjet, përgjigjet të jenë më të sakta dhe kolegët të fokusohen te pyetjet dhe jo te komentet.

Mund ta përmbyllni mendimin lidhur me pyetjet e zotit Hyseni, pastaj radhën e ka zonja Felaj.

Erinda Ballanca – Atëherë, për sa i përket çështjes së Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese, siç ne e dimë, nuk e ka rrëzuar kërkesën që ka bërë Avokati i Popullit, por nuk ka pasur kuorum për ta miratuar. Pra, ka dy qëndrime, një pjesë e ka miratuar, sepse ka pasur kuorum për të miratuar një çështje dhe për një problem tjetër nuk ka pasur 5 vota pro. Nuk quhet ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi profesionist bashkë. Nuk ka pasur 5 vota kundër, atëherë duhet të ishte rrëzuar. Ka tri qëndrime, nuk ka refuzim, që do të thotë se ti mund ta ngresh prapë kërkesën kur të jetë numri dhe ne vazhdojmë të kemi po të njëjtin qëndrim si Avokati i Popullit, i cili, jo domosdoshmërisht duhet të jetë i njëjtë me qëndrimin e gjykatave. Ne kemi standardet më të larta të të drejtave të njeriut. Edhe me Gjykatën Kushtetuese, në të gjitha rastet, ne kemi një standard, i cili, në gjykimin tonë, është standardi më i lartë i të drejtave të njeriut.

Për sa i përket kësaj çështjeje, ne jemi shumë të qartë në gjykimin tonë, pasi për sa kohë kemi bërë kërkesën, ne kemi këtë qëndrim. Zoti Hyseni, që ta dini, kërkesa nuk është bërë në kohën time.

Në qoftë se do të krijohet kuorumi në Gjykatën Kushtetuese, ne kemi të drejtë ta paraqesim atë kërkesë përsëri. Si profesionist që jemi, kjo është praktika.

Për sa i përket çështjes së veprave penale dhe mbipopullimit të komisarivateve, mund të flasim specialistët e kësaj fushe, për të thënë pse e kanë futur në raport këtë terminologji për ngritjen e veprave rast pas rasti, por nuk mendoj se ka pasur ndonjë qëndrim të Avokatit të Popullit që të mendojnë se në Shqipëri janë shtuar tani veprat penale në lidhje me drogën. Është e vërtetë që është forcuar politika penale dhe nuk është gjë e keqe që kjo të ndodh, pasi ajo duhet rast pas rasti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në komision janë të ftuar komisioneri për çështjet e policisë dhe burgjeve, si dhe komisioneri i mekanizmit, të cilët mund të flasim për këtë term.

Për sa i përket ndihmës ekonomike, ndër vite qëndrimi i Avokatit të Popullit ka qenë që masa e ndihmës ekonomike është shumë e ulët për të përballuar nevojat e qytetarëve për të jetuar dhe ky qëndrim nuk ndryshon. Pavarësisht reformës që është bërë, janë përjashtuar nga skema

persona, të cilët duhet të trajtoheshin me ndihmë ekonomike, ashtu si në shumë raste reforma ka vepruar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ka përjashtuar persona, të cilët merrnin ndihmë ekonomike pa plotësuar kushtet e përfitimit të saj, sepse kanë qenë të punësuar apo arsye të tjera. Ne mendojmë që ndihma ekonomike duhet të jetë një alternative dhe jo e vetmja mënyrë që qytetarët të jetojnë. Ne duhet të krijojmë politika punësimi në mënyrë që qytetarët të punësohen, sepse vetëm nëpërmjet punësimit do të mund të krijojnë një jetë të përshtatshme për familjet dhe veten e tyre. Ky është qëndrimi ynë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Në raportimin tuaj më tërhoqën vëmendjen dy momente. Ndoshta jam në të njëjtin nivel konsiderate me kolegun parafolës, por do të doja të ishit thelluar më shumë në atë që raportoni.

Së pari, ju thoni se Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i duhet rritur buxheti për pajisjen me uniformë të punonjësve. Në fakt, buxheti i vitit 2018 e ka marrë parasysh këtë kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. I gjithë sistemi i Burgjeve, që i kishte punonjësit e vet të papajisur me uniformë të re që prej vitit 1993, ka marrë edhe këtë shtesë në buxhet, sikundër ka buxhetin më të madh që ka pasur ndonjëherë.

Së dyti, ju folët për mbipopullim në burgje. Gjatë viteve 2013-2017 janë ndërtuar disa burgje dhe paraburgime të reja, si: paraburgimi i Beratit, burgu i ri i Fierit, burgu i Malësisë së Madhe, burgu për të miturit në Kavajë. Nëse ju e keni parë gjithmonë me këtë sy, si ka ardhur kurba e mbipopullimit në vite? Sa është mbipopullimi? Ku është përqendruar? Unë mendoj se kjo e dhënë do të ndihmonte edhe në projektimin e së ardhmes.

Burgjet janë ndërtuar me logjikën ku ka përhapje më të madhe të veprave penale apo ku kemi numrin më të madh të të dënuarve. Vetëm nga emrat e vendeve ku janë ndërtuar këto burgje, kuptohet që duhet të kenë çliruar diçka.

Preferoj që në raportimin e ardhshëm ju ta kini këtë analizë, në mënyrë që vit pas viti ne të kuptojmë sa është mbingarkesa në burgje dhe sa na ndihmojnë burgjet dhe paraburgimet e reja për ta ulur këtë mbingarkesë. Të mos harrojmë se edhe Kuvendi në rolin e vet, të paktën këto vitet e fundit, ka ruajtur një politikë të tillë duke dhënë amnisti çdo vit. Një nga arsyet publike që kanë

justifikuar miratimin bashkarisht të këtyre ligjeve për amnisti ka qenë pikërisht ulja e mbipopullimit në burgje.

Ulsi Manja – Faleminderit, zona Felaj!

Po, zonja avokate.

Erinda Ballanca – Për sa i përket raportimit që ne kemi bërë, në faqen 18 të raportit themi: “ulje e mbipopullimit krahasuar me vitet e mëparshme nga një rishpërndarje më e përshtatshme e të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEPV”. Pra, e kemi pranuar këtë gjë dhe e kemi thënë në mënyrë të qartë. Megjithatë, situata në IVSHB vazhdon të mbetet problematike. 35 persona të dënuar, të cilët ishin me probleme të shëndetit mendor, nga të cilët dy gra ishin në patologji, flinin me dyshekë përtokë, në shkelje flagrante të nenit 24. Pra, ne i kemi thënë në mënyrë të hollësishme gjetjet tona duke pranuar që ka ulje të mbipopullimit, edhe pse ai vazhdon të mbetet problematik. Burgu i Tepelenës vazhdon të jetë në një gjendje shumë të keqe mbipopullimi.

Pavarësisht problematikave që janë ngritur dhe që vit pas vitit janë marrë parasysh (nuk themi se rekomandimet e Avokatit të Popullit për këtë çështje nuk janë marrë parasysh), është e rëndësishme të theksojmë, në kuadër të parandalimit, se aty ku mbipopullimi vazhdon të mbetet problem duhet ta evidentojmë. Kjo është detyra jonë në rolin e Avokatit të Popullit si mekanizëm për parandalimin e dhunës. Një gjë të tillë e kemi bërë.

Për sa u përket analizave se ku duhet të ngrihen apo nuk duhet të ngrihen këto institucione, në Ministrinë e Drejtësisë ka një strukturë të posaçme që merret me këto çështje.

Në prezantimin e raportit 2-vjeçar të buxhetimit për dy vitet e ardhshme, ku ishim të ftuar edhe ne bashkë me Ministrinë e Drejtësisë, janë marrë në konsideratë disa programe për përmirësimin dhe vazhdimin e përmirësimit të gjendjes së burgjeve duke ndërtuar burgje të reja. Në burgje ka situata shumë të vështira dhe shumë të rënda.

Jo më larg se dje ne inspektuam burgun e Durrësit dhe gjendja nuk ishte nga më të mirat. Në këtë kuptim, të paktën për sa i përket situatës në burgje, ne mendojmë se raportet tona janë shumë të hollësishme.

Raporti që ne po paraqesim është një përmbledhje e gjithë punës sonë gjatë vitit. Neve na është tërhequr vëmendja në mënyrë të vazhdueshme, sepse raportet kanë qenë shumë të gjata dhe për këtë shkak të palexueshme. Raportet duhet të jenë më sintetike. Nëse ju keni, qoftë si Komision i Ligjeve, qoftë si anëtarë të parlamentit, kërkesa për punën tonë për periudha apo çështje të tjera, ne jemi të gatshëm t’ju japim informacion për të gjithë punën tonë në mënyrën më specifike, por

këtë vit kemi zgjedhur ta bëjmë sa më kompakte. Këto që ne kemi sjellë janë përmbledhje e rekomandimeve që u janë dërguar rast pas rasti ministrave, drejtorive të burgjeve, komisariateve dhe gjithandej.

Kjo ka qenë fryma që ne kemi pasur për të bërë një raport sintetik edhe në linjë me frymën e raporteve të ngjashme të avokatëve të popullit nëpër botë. Avokatët e popullit nëpër botë thonë vetëm cilat kanë qenë pesë çështjet më të rëndësishme për Avokatin e Popullit dhe vetëm ato trajtojnë. Ka edhe frymë të tilla për sa i përket raportimit. Gjithsesi ne jemi të gatshëm në çdo moment të bëjmë raportime sipas rasti.

Për sa i përket çështjes së uniformave, ky rekomandim është përfshirë në këtë raport, sepse ne e kemi çuar më herët. Pra, ne e kemi çuar rekomandimin në mes të vitit 2017 dhe ai është marrë parasysh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Raportimet rast pas rasti ne i bëjmë për vitin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si ta azhurnoj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk e dimë cili është i buxheti. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve duhet të na ftonë

...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve e ka bërë këtë kërkesë edhe mbi bazën e rekomandimit të Avokatit të Popullit. Ajo duhet të na informonte që e kishte plotësuar rekomandim tonë. Ka qenë rekomandimi ynë dhe për sa kohë që ka qenë një ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Parlamenti ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erinda Ballanca – Ne i kemi thënë parlamentit një gjë të vërtetë.

Ulsi Manja – Ju lutem!

Mund ta ndizni mikrofonin!

Ermonela Felaj – Duhet mbajtur përgjegjësi për gjërat që thuhet. Për korrektësi, situatat përshkruhen ashtu siç kanë ndodhur. Është fikse e njëjta gjë, si ajo që thamë për ndihmën

ekonomike. Deri në fund të vitit 2017 ende nuk kishte filluar zbatimi i modelit të ri të ndihmës ekonomike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Diskutimet kanë qenë më vonë. Filloi më herët me zbatimin në disa rajone dhe më pas u shtri në 12 qarqet e Shqipërisë, por efektet e para i kemi marrë gjatë vitit 2018. Për këtë ka pasur edhe një seancë të mëparshme në parlament. Ndërkohë, është e vërtetë për t'u thënë dhe për t'u lavdëruar, sepse këto janë mundësitë e vendit tonë. Për këtë duhet të jemi shumë të ndërgjegjshëm dhe mund të dëshirojmë shumë më tepër për të gjithë, por po të bëjmë më të mirën e asaj që kemi. Ndihma ekonomike sot është 2-fishuar. Sot ndihmën ekonomike në fshat e merr një numër i dyfishuar njerëzisht dhe modeli synon atë që ju e thatë si opinion tuajin: të zëvendësohet dhënia e ndihmës si në moshë dhe ndihma të jepet vetëm për ata që kanë realisht nevojë për të, ndërsa të tjerët që janë në kushtet për të punuar dhe këtë bën modeli i ri i ndihmës ekonomike, t'u ...

Erinda Ballanca – Zonja Felaj,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – A ka mundësi?

Megjithatë, ky nuk është thelbi.

Ermonela Felaj – Thelbi i tërheqjes sime të vëmendjes ishte pikërisht këtu: kur raportojmë është mirë të azhurnohemi deri në fund me atë që ka ndodhur, në mënyrë që një gjë e pavërtetë të mos zërë vend në raport. Kaq.

Erinda Ballanca – Zonja Felaj,

Raportimi ka një periudhë të përcaktuar dhe unë e kam të shënuar.

Ulsi Manja – Dakord. Të gjitha shënimet, komentet dhe vërejtjet e bëra nga kolegët deputetë, do t'i bëjmë pjesë të rezolutës për institucionin e Avokatit të Popullit, që do ta miratojmë në Kuvend.

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Nëse nuk ka pyetje të tjera nga kolegët, përpara se t'ia jap fjalën koleges Xhina për të bërë një përmbledhje të të gjithë raportit, kam unë një pyetje.

Zonja avokate,

Ka pasur një prononcim tuajin gjatë një procesi që ju keni monitoruar në komisionet e vetingut, para dhënies së një vendimi konkret nga ana e këtij komisioni, që ka qenë një opinion jo pak i kritikuar.

Si mendoni ju, a është në tagrin e kompetencave që ju jep ligji (jo vetëm ligji juaj si ligj organik, por edhe ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve), një prononcim në sallën e komisionit të vetingut?

Në këndvështrimin tuaj, a konsiderohet kjo një ndërhyrje në pavarësinë e punës së këtij institucioni?

Fillojeni nga të doni, por kjo ishte pyetja ime. Do t'ju lutesha shkurt!

Erinda Ballanca – Së pari, kjo është në fakt një nga ato çështje, e cila në gjykimin tim kërkon një trajtim tërësor. Më vjen keq, por nuk mund t'i bie fare shkurt.

Ulsi Manja – Më falni!

Unë e kisha shumë koncize pyetjen.

Si mendoni ju, a është në tagrin e kompetencave që ju jep ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH, një prononcim juaji para dhënies së një vendimi?

Pas kësaj desha të kem një opinion, nëse është ndërhyrë në pavarësinë e këtij institucioni, apo jo.

Erinda Ballanca – Atëherë, prononcimi që unë kam dhënë nuk ka qenë në asnjë rast një prononcim se si duhet të ishte vendimi i komisionit të vetingut. Nuk e kam bërë një gjë të tillë dhe nuk jam prononcuar në sallën e komisionit të vetingut. Unë jam kujdesur në çdo germë të asaj që kam thënë, për të thënë se është kompetenca e komisionit të vetingut për të marrë çdo lloj vendimi, në lidhje me këtë çështje.

Përgjigja e pyetjes së gazetarit: si e njihni ju këtë person, unë i jam përgjigjur (dhe e kam të transkriptuar të gjithë përgjigjen që kam dhënë): “Ju e dini që unë jam një person që kam konsumuar shumë drejtësi në këto 20 vjet, që jam në këtë profesion dhe kam njohjet e mia për sa u përket personave, por kjo, është pavarësisht vendimmarrjes së komisionit të vetingut. Unë e kam njohur si një ndër gjyqtarët më korrektë. Kam thënë se unë mendoj (këtë e kam thënë në vetën e parë), vendimin në lidhje me këtë çështje e merr komisioni i vetingut.”

Pra, në asnjë rast unë nuk kam paracaktuar, as mund ta mendoja se mund ta paracaktoja, edhe për shkak të eksperiencës sime shumë të gjatë, se çfarë vendimi do të merrte komisioni i vetingut.

Avokati i Popullit në mënyrë të qartë e ka të përcaktuar në ligj mbrojtjen e standardeve më të larta të zbatimit të të drejtave të njeriut. Një proces i rregullt ligjor, i cili është baza e procesit të vetingut, është përcaktuar qartësisht, si një nga shtyllat dhe një nga të drejtat themelore të njeriut.

Për më shumë, kjo ishte përgjigje e pyetjes së bërë nga gazetarët. Unë nuk vajta atje për të bërë ndonjë deklaratë, por ato ishin pyetje, të cilat janë bërë drejtpërdrejt nga gazetarët, duke iu përgjigjur qëndrimit dhe mendimit të opinionit publik.

Ne, si institucion i Avokatit të Popullit, kemi marrë pjesë në çdo seancë, e cila është zhvilluar nga dita e parë deri sot me stafin e organit që unë përfaqësoj, për ta ndjekur dhe për ta monitoruar procesin.

Së dyti, unë kam thënë: në pikëpamje të parë, nga ajo që unë shoh, garancitë procedurale janë të rregullta. Bile pyetjes, nëse ka shkelje të të drejtave në këtë proces, iu përgjigja se në pikëpamje të parë, garancitë procedurale janë garantuar.

Në këto kushte, unë do të doja shumë dhe shpresoj se, duke qenë se secili prej nesh vihet herë pas here në pozicione të tilla, ku nuk gjykohet nga ato që ka thënë realisht, por nga ato që ka menduar se ka dëgjuar gazetari i radhës, apo mendimin e mendimit të mendimit, do të doja të kërkoja mirëkuptimin e të gjithëve që çdo deklaratë dhe çdo diskutim të trajtohet dhe të shikohet në kuadër të asaj që unë kam artikuluar dhe kam thënë.

Besimi që duhet të ketë populli në të gjithë sistemin e vetingut është një nga vlerat më të rëndësishme, gjykoj unë, që secili prej nesh duhet ta ruajmë mirë. Po humbi besimi te procesi i vetingut, ne nuk do të arrijmë të realizojmë realisht asnjëherë atë që ishte qëllimi i institucionit, i parlamentit dhe i të gjithë shoqërisë shqiptare për të kryer një proces për të reformuar sistemin e drejtësisë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ju thatë se i gjithë procesi i vetingut monitorohet nga Avokati i Popullit në të gjitha seancat, por vetë Avokati i Popullit, si drejtues i këtij institucioni, zgjodhi vetëm një rast për të bërë një prononcim për të vlerësuar standardet e komisionit të vetingut. Kjo ndoshta është keqkuptuar nga opinionit publik.

Gjithsesi, faleminderit për përgjigjen!

Fjalën e ka zonja Xhina, si relatore, për të na bërë një përmbledhje të shkurtër!

Elena Xhina - Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të falënderoj zonjën avokate për parashtrimin e bërë.

Dua të falënderoj, gjithashtu, edhe kolegët për pyetjet e bëra, të cilat bënë që të plotësohet edhe më shumë raporti i avokates.

Unë e kam lexuar me kujdes këtë raport dhe e përgëzoj për punën e bërë. Janë prekur pothuajse të fushat e të drejtave, si dhe janë monitoruar me kujdes veprimtaritë e administratës publike dhe institucioneve të tjera shtetërore.

Gjithashtu, gjendet me vend që çdo problematikë e dalë në këtë komision, nga pyetjet e kolegëve, sugjerimet e tyre dhe rekomandimet, do të pasqyrohen në projektrezolutën që do t'i paraqitet përsëri këtij komisioni. Duhet të kihet parasysh nga ky institucion në raportimin e ardhshëm, që të bëhet një analizë krahasuese me vitin e mëparshëm, që anëtarët e komisionit ta kenë më të lehtë për të parë përparësitë dhe problematikat e institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, lidhur me rekomandimet, do të këshillojmë që, nga ana juaj, të ndiqej mënyra si duhen zbatuar rekomandimet deri në momentin që do të paraqitet edhe raportimi para Kuvendit, për të mos pasur problematika në koherencë apo me azhurnimin e informacionit të dhënë.

Në këto kushte, meqenëse të gjitha pyetjet u ezauruan, nuk më mbetet gjë tjetër veçse t'ju uroj punë të mbarë për vitin në vijim dhe të shpresoj që rezoluta që ne do të përgatisim të jetë e përmbushur tërësisht vitin e ardhshëm.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Në fakt, mua më takon fjala e fundit, në kuptimin e mbylljes së kësaj mbledhjeje të gjatë për ditën e sotme.

Kërkoj nga relatorja dhe nga të gjithë kolegët, por edhe nga shërbimet e Kuvendit, që të përgatitet një rezolutë e qartë, e saktë dhe e detajuar (që do t'i kalojë seancës plenare), ku të reflektohen të gjitha shqetësimet që Komisioni i Ligjeve ka në raport me institucionin e Avokatit të Popullit, pse jo edhe të vëmë në rezolutë, në fokusin kryesor të rekomandimeve tona, detyrat që vetë ligji i ngarkon këtij institucioni. Natyrisht, këtu nuk mund të shmangen edhe detyrimet që ka Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe, posaçërisht, Komisioni i Ligjeve në raport edhe me institucionin e Avokatit të Popullit.

Duke qenë se zonja Avokate, në fakt, iu drejtua disa herë kolegut tim, Fino, për shkak edhe të traditës që ka tashmë ky komision prej shumë vitesh, ku ky i fundit është relator i projektbuxhetit të institucioneve, që varen ose burojnë nga Kuvendi në këtë komision, por edhe njohës i mirë i strukturave të këtyre institucioneve, do t'i kërkoja institucionit të Avokatit të Popullit, si përherë edhe Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit, duke qenë se jemi edhe në prag të ardhjes së buxhetit të vitit 2018, pra do të vijë shumë shpejt në Kuvend (besoj në fillimin e gjysmës së dytë të këtij

viti), që të mos ngelen vetëm në kuadrin e kërkesave apo të fjalëve sa herë vihet para këtij komisioni për strukturën, për buxhetin apo për mungesën e personelit, por ta rishikoni strukturën e institucionit të Avokatit të Popullit. Pse jo, Kuvendi për këtë punë është, ne marrim përsipër përgjegjësitë tona në raport me institucionin tuaj, siç do të kërkonim nga Avokati i Popullit, që në reflektim të të gjitha shqetësimeve të kolegëve, pavarësisht se raporti i vitit 2017, përkon me gjysmën e kohës që ju jeni në drejtim të atij institucioni, të meritojë plotësisht fjalën Avokat i Popullit.

Është shumë e rëndësishme që ai institucion, pavarësisht ecurisë dhe dinamikës që nga koha e krijimit deri sot, do të duhet të ngelet institucioni i Avokatit të Popullit, sepse edhe kështu siç është, ka bërë goxha përparime, pse jo, është edhe një derë e çelur për të gjithë ata qytetarë shqiptarë, që vendosin t'i drejtohen këtij institucioni krahas shumë institucioneve të tjera, ku qytetarët kanë aksesin për t'iu drejtuar për të zgjidhur hallet, problemet e tyre në raport me pushtetet e tjera.

Kështu që, duke u bashkuar me mendimin e të gjithë kolegëve të mi këtu, shpresoj të kemi një rezolutë të dakordësuar dhe të fokusuar qartësisht në drejtim të punës së këtij institucioni, edhe si një ndihmë që Kuvendi i Shqipërisë ofron në drejtim të institucionit të Avokatit të Popullit. Kam parasysh këtu edhe çështjen e strukturës, edhe çështjen e buxhetimit të këtij institucioni, sigurisht me mundësitë që ka buxheti i shtetit, por që do të duhet ta vëmë edhe institucionin e Avokatit të Popullit në raport me të gjitha institucionet e tjera, që monitorojnë zbatimin e ligjit dhe të drejtat e liritë themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

Tani, nuk më mbetet gjë tjetër veçse ta falënderoj Avokaten dhe stafin shoqëruar të saj për prezantimin e bërë sot në komision!

Falënderoj gjithashtu edhe kolegët e mi të Komisionit të Ligjeve (të Partisë Socialiste) për durimin e treguar, duke marrë në konsideratë pjesën e parë të kësaj mbledhjeje, ku, në fakt, nuk ishte dita e duhur sot, për shkak se përpara kishim Avokaten e Popullit për të raportuar! Unë, në fakt, besoj tek institucionet dhe jo tek ato që thonë partitë politike, madje besoj shumë tek institucionet e vendit tim, pasi, më mirë sesa institucioni i Avokatit të Popullit, nuk mund të flasë kush për shqetësimet dhe hallet që ka populli, të paktën për atë sferë veprimtarie që mbulon vetë Avokati i Popullit.

Por dua të falënderoj edhe mediet për transmetimin e kësaj seance të ditës së sotme, pasi edhe kjo është në shërbim të informimit të publikut, pse jo, edhe një ndihmë në punën e

institucionit të Avokatit të Popullit, të Komisionit të Ligjeve dhe të Kuvendit të Shqipërisë në kuadër të transparencës me opinionin publik!

Edhe një herë faleminderit dhe ditë të mbarë!

Mbledhja e radhës do t'ju njoftohet nga sekretaria nëpërmjet postës elektronike së bashku me rendin e ditës.

MBYLLET MBLEDHJA